

# FSHATRAT FANTAZMË

EMIGRIMI VERSUS BURIMET POTENCIALE TË SHQIPËRISË

## GHOST VILLAGES

EMIGRATION VERSUS POTENTIAL RESOURCES OF ALBANIA





**FSHATRAT FANTAZMË**  
**EMIGRIMI VERSUS BURIMET POTENCIALE TË SHQIPËRISË**

GHOST VILLAGES  
EMIGRATION VERSUS POTENTIAL RESOURCES OF ALBANIA

**GHOST VILLAGES**  
**Emigration versus Potential Resources of Albania**

**Text** Luljeta Lleshanaku, Christian Filips, Ben Andoni

**Pictures** Vjola Leskaj

**Video** Elton Baxhaku

**Project Coordinator** Klaudja Zerva

**Design** Henrik Lezi

**Cover** Vjola Leskaj

SCAN WITH YOUR PHONE CAMERA TO WATCH THE VIDEO DOCUMENTARY



©Konrad-Adenauer-Stiftung Albania, 2020

The author shall be solely responsible for the facts and views expressed in this publication and his/her interpretation and other opinions do not necessarily reflect the opinions or policies of the Konrad- Adenauer-Foundation



# PARATHËNIE

## PREFACE

**DR. TOBIAS RÜTTERSHOFF**

Drejtor i KAS Shqipëri - Director of KAS Albania

Ndonëse ka popullsi fare të vogël, prej 2.8 milionë banorësh, sipas statistikave të fundit të Kombeve të Bashkuara, fatkeqësisht, Shqipëria renditet ndër vendet e para për nga numri i personave që emigrojnë jashtë vendit. Qytezat dhe fshatrat po përballen prej kohësh me eksode të njëpasnjëshme, duke u kthyer kështu në vende të shkretuara dhe të vetmuara. Të rinjtë po emigrojnë masivisht në shifra të larta, duke u kthyer në problem serioz kombëtar. “Emigrimi i trurit” po dëmton më tej shoqërinë dhe ekonominë shqiptare, duke sjellë kështu një rreth vicioz degradimi dhe emigrimi.

Në këtë kuadër, Fondacioni Konrad-Adenauer, zyra për Shqipërinë organizoi udhëtimin studimor “Emigracioni: Një udhëtim në fshatrat fantazmë të Shqipërisë” për të sjellë më në

Despite a small population of about 2.8 million people, Albania is sadly among the top countries with the most people emigrating abroad, according to the latest United Nations statistics. Towns and villages are experiencing a constant exodus and are becoming deserted and lonely places. Mass emigration of young people is taking place in large numbers directly abroad, making it a severe national problem. This “brain drain” is further damaging the Albanian society and economy, leading to a vicious circle of decline and emigration.

Against this background, Konrad-Adenauer-Stiftung Albania organized the study visit “Migration: A journey through the ghost villages of Albania” to draw more attention to the existential threat to Albanian villages through

fokus kërcënimin ekzistencial të fshatrave nga emigracioni. Gjashtë pjesëmarrësve, shqiptarë dhe të huaj, përfshi shkrimtarë, fotografë, gazetarë dhe regjisorë, iu dha mundësia që të vëzhgonin drejtpërdrejt dhe të dokumentonin ndikimin e emigracionit në këto vende të lëna pas dore. Banorët e këtyre “fshatrave fantazmë” kanë hedhur rrënjë të forta në tokat e tyre, për të cilat punojnë pareshtur. Përmes kontaktit personal me personat e prekur nga emigracioni, përvojat e këtyre të fundit janë reflektuar artistikisht, duke i vënë kështu në qendër të vëmendjes së shoqërisë. Karakteri shumëkombësh i projektit mundësoi dialogun ndërkulturor dhe shkëmbimin e veçantë të përvojave, duke qenë se personat që jetojnë në vendet e destinacionit nuk ia kanë thuar fare idenë se si është jeta në rajonet nga vijnë emigrantët. Udhëtimi studimor pati disa faza. Së pari, pjesëmarrësit folën rreth emigracionit me kursantët në Qendrën Goethe në Tiranë. Ata treguan arsyet dhe qëllimin se përse po mësonin gjuhën gjermane. Një temë mjaft e veçantë gjatë shkëmbimit të ideve ishte mospërputhja midis pritshmërive dhe realitetit të emigracionit. U diskutuan në mënyrë kritike veçanërisht idealizimi i Gjermanisë dhe

emigration. Six participants from Albania and abroad, including writers, photographers, journalists, and filmmakers, had the opportunity to directly observe and capture the impact of migration in typically neglected places. The inhabitants of these “ghost villages” are often rooted in a special way with their land and its development. Through personal contact with people affected by immigration, their experiences were reflected artistically and are, thus, brought into the consciousness of society. Due to the multinational character of the project, intercultural dialogue and a special exchange of experiences was achieved, since people in destination countries often have little idea of life in the regions where the migrants come from.

The study visit consisted of several stages. First, the participants talked to language students at Goethe-Center Tirana about migration. They told about their motivation for learning German and the goals they are pursuing with it. A special topic in the exchange was the conflict between expectations and reality of migration. In particular, idealizing views of Germany and migrating there were critically discussed. Second, the group travelled to

koncepti i emigracionit. Së dyti, grupi udhëtoi drejt fshatrave të ndryshme të Shqipërisë së Veriut dhe Jugut për të mësuar rreth përvojave dhe pritshmërive në ato zona. Në Jug, patën mundësinë të vizitonin fshatin e peshkimit të Nartës në Vlorë. U tregua interes i veçantë për gjendjen e industrisë së peshkimit dhe pakicës greke që jeton atje, brezat e rinj të së cilës kanë emigruar kryesisht në Greqi. Në Veri, ata vizituan qytezat e Rubikut dhe Kukësit. Industria minerare e rajonit u la në terr pas rënies së regjimit të Hoxhës, çka solli humbjen e shumë vendeve të punës. Grupi vizitoi edhe qytetin e Shkodrës dhe fshatin Zogaj në afërsi të kufirit me Malin e Zi.

Rezultatet e këtij udhëtimi mund të shihen në këtë botim. Tregimet, fotografitë dhe dokumentarët synojnë nga njëra anë të ndërgjegjësojnë autoritetet dhe arenën ndërkombëtare për këto probleme, dhe nga ana tjetër, mbi të gjitha, t'u ofrojnë të rinjve shqiptarë një perspektivë shpresëdhënëse për jetën në vendin e tyre. Në tërësi, projekti dhe ky botim dëshirojnë që të dëgjohet edhe zëri i atyre për të cilët nuk para lobohet. Ju urojmë lexim sa më të këndshëm dhe frytdhënës!

different villages in Southern and Northern Albania, to capture the different experiences and expectations there. In the South, they had the opportunity to visit the fishing village Narta near Vlore. The condition of the fishing industry and the Greek minority living there, whose younger generations have mostly emigrated to Greece, were of special interest. In the North, they travelled to the small towns of Rubik and Kukes. The mining industry in this region was dismantled after the end of the Hoxha regime, which was accompanied by the loss of many jobs. The group also visited the city of Shkoder and the fishing village of Zogaj near the Montenegrin border.

The results of this trip can now be seen in this publication. With reports, photographs and documentaries, the aim is on the one hand to make the authorities and international audience more aware of the problems, but above all to give young Albanians a hopeful perspective on life in their country. Overall, the project and this publication want to make the voices of those heard who often do not have a lobby. We wish a pleasant and informative reading!





# “FSHATRAT FANTAZMË: POTENCIALI I PAPËRDORUR I SHQIPËRISË”

“GHOST VILLAGES: THE UNUSUAL POTENTIAL OF ALBANIA”

LULJETA LLESHANAKU

## Retrospektivë 1

Para tre vitesh, më takoi të bëj udhëtimin më të çuditshëm që kam bërë ndonjëherë, të ngjashëm me një episod të ndonjë romani të Realizmit Magjik: daja im, në moshë tashmë të thyer dhe i vetmi trashëgimtar i atij brezi në familje, telefonon papritur dhe me kërkon mua dhe dy djemve të tij që të bënim një udhëtim urgjent nëpër tre-katër fshatra rreth Laçit dhe Mamurrasit, për të parë fizikisht se ku ndodheshin “pronat tona”. Ishte mesi i verës, temperatura 38 gradë, dhe askush prej neve të treve, nuk kishte kurrfarë interesi për t’u ardhur rrotull me makinë apo për më tepër më këmbë atyre fushave përvëluese. Dhe kryesorja: ne nuk na lidhte asgjë me ato që ai i quante “pronat tona”, përveç disa tapive të cilat për tridhjetë vjet me radhë vetëm ishin sorollatur nga njëri institucion në tjetrin, nga një avokat në tjetrin, duke i thelluar edhe më tepër xhepat tona të zbrazët.

## Retrospective 1

Three years ago, it just so happened that I set off on the strangest trip of my life, reminiscent of an episode from a Magic Realism novel. My maternal uncle, in his old age and as the only male in his family’s generation, suddenly called and requested me and his two sons to embark on an urgent trip to three or four villages around Laç and Mamurras, to witness where “our properties” were located. It was midsummer, the temperature reached 38°C, and none of us was enthusiastic about driving or walking under the blazing sun, not to mention our complete dissociation with what he called “our properties”; besides a few ownership titles which, for 30 consecutive years, had transferred from an institution to another or from one lawyer to the other, only serving to further drain our resources.

Sado që ne i rezistuem këtij udhëtimit, fjala e dashës që urdhër. “Ja, deri këtu shtrihej toka e gjyshit tuaj!” Ose, “E sheh atë grup shtëpish atje? Dikur ka qenë hani i gjyshit tuaj!” Ose, “Dikur këtu ka qenë një pyll, por pushteti i asaj kohe e rrafshoi dhe e ktheu në tokë buke” Ose, “Këtu ka qenë mulliri ku bluhej gruri. Mendojeni se në atë kohë nuk kishte as makina, dhe transporti bëhej vetëm me kuaj. “Dhe vendasit shihnin të habitur katër të huaj që bridhnin si fantazma prej mishi, ditën për diell, nëpër tokat e tyre: një burrë plak të dobësuar në 40 kg, dhe tre të tjerë shumë më të rinj në moshë, që e ndiqnin nga pas me dembelizëm. Ndalo dhe pyet: ku fillonte dhe ku mbaronte “toka jonë”? Terreni ishte transformuar, dhe ne na duhej ndihma e tyre, por vendasit na shihnin me një palë sy armiqësorë. “Mos kini frikë! Edhe po te dua, nuk jua marr dot tokën se nuk ma lejon ligji! Por desha vetëm t’u tregoj fëmijëve se cilat janë pronat që u la gjyshi i tyre. E ndjej për detyrë!” - iu përgjigj njërit prej tyre daja, i cili do të ndërronte jetën nga kanceri vetem pas dy muajsh. “As ne nuk po e gëzojmë! Ne na mbajnë fëmijët emigrantë, se me një copë tokë nuk jetohej!” u përgjigj fshatari, me një buzëqeshje të hidhur. Tokat, disa dynym, që gjyshi i kishte vënë me punë, iu sekuestruan nga reformat komunise në fillim të vitit 1945, dhe pas rrëzimit të sistemit komunist, shteti i ri demokratik, me ligjin 7501, thjesht ri-legjitimoi reformën komuniste, duke ua lënë në pronësi bujqve tokën, ndërkohë që njohu ligjërisht edhe sekuestrimet, pra, pronarët e ligjshëm. Aktualisht, tokat në Shqipëri kanë dy pronarë: atë që e punon, dhe atë që e zotëron, deri në një moment kompensimi. Dhe ky kompensim vetëm zvarritet pafundësisht, duke i mbajtur peng të dyja palët. Ndërkohë asnjë investim nuk mund të bëhet në një tokë me dy pronarë; Industrializimi i bujqësisë, pra krijimi i fermave të mëdha dhe futja e teknologjise, është i pamundur meqenëse asnjëra palë nuk gëzon të

Despite our resistance, our uncle ordered us to take this trip. “Here lay your grandfather’s land!” Or, “Can you see that bunch of houses over there? That used to be your grandfather’s inn!” Or “There used to be a forest here, but the regime at the time had it cut into a wheat land.” Or, “This was where the flour mill used to be located. Keep in mind that at the time, there were no cars and transportation was only possible by horse.” And the locals were astounded to see four strangers, in broad daylight, walking around their land like living ghosts: a 40-kg old man and three other young people, idly following closely behind. We stopped and asked: where did “our land” extend? The territory had been transformed and we needed the locals’ help, who actually gave us an unfriendly welcome. “Please, do not be afraid! I would not be able to take this land away from you even if I wanted to. The law forbids it! The only thing I wanted was to show my children and niece the properties their grandfather left them. It is my duty!” - my uncle, who would die from cancer merely two months later, told one of the locals. “It’s not that we are using the land either! Our migrant children are providing for us, for we cannot get by only with this land!” - One of the villagers replied, with a faint smile on his lips. The several dynym<sup>1</sup> land, which our grandfather had earned through work, was seized by communist reforms in early 1945. Subsequently, upon the fall of the communist regime, the new democratic state, via Law No. 7519, simply religitimized the communist reform leaving the land to farmers, while at the same time recognising the confiscations, e.g. legal owners. Currently, lands in Albania have two owners: the farmer working the soil, and the legitimate own-

---

1. *Translator’s note: An Albanian measurement of land area equal to 2,000 m<sup>2</sup> or 0.2 hectares.*



drejtën e pronës. Dhe ndodh pastaj që produktet e importit konkurojnë për nga çmimi produktin bujqësor vendas, duke e çuar drejt falimentimit bujqësinë vendase. Për një ekonomi bujqësore si e jona, kjo sjell pasoja të rënda. Dhe të pashpresë, të gjithë synojnë emigracionin, ku natyrisht do të punojnë tokat e të tjerëve, duke e lënë mbresa djerrë tokën e tyre.

er, until its compensation. This compensation takes an eternity and is time-consuming for both parties. In the meantime, no investments can be made on land with two owners; Agriculture industrialisation, e.g. establishing large farms and introducing technology, is impossible, as none of the parties are entitled to ownership. And it so happens that import products have better

## Retrospektivë 2

Jo shumë shpesh, por çdo vit, kthehem në qytetin tim të fëmijërisë, në Krujë, një nga sítet turistike më të frekuentuara në Shqipëri (ose së paku e tillë figuron në guida), prej kështjellës së Skënderbeut, simbolit të rezistencës kundër osmanëve, ngjarjes më të rëndësishme historike që e bëri të njohur Shqipërinë në Europë. Kruja është një qytezë pa industri, që gjithë këto vite ka mbijetuar prej artizanatit, turizmit dhe dy-tri fasonerive të vogla. Por edhe pse shumë e favorizuar si zonë (vetëm 36 kilometra nga Tirana dhe 12 km nga aeroporti ndërkombëtar), pavarësisht rëndësisë dhe sjelljes bujare të vëndasve, qyteti po e humbet me shpejtësi sharmin e tij. Një grup turistësh slovenë u kthyen mbrapsht, porsa iu shfaqën kodrat e gërryera nga furrat e gëlqeres në hyrje të qytetit. Gropa dhe tym. Nga ana tjetër, ndërtimet jashtë çdo lloj standardi urbanistik, një tjetër gjurmë e keqmenaxhimit gjatë tri dekadave të fundit, e kanë banalizuar identitetin arkitekturor të këtij qyteti, duke sjellë një zhgënjim akoma më të madh tek vizitorët.

Rezultati? Sa herë që kthehem në qytezën time të dashur, gjej me pak të njohur. Banorët emigrojnë çdo ditë, drejt Gjermanisë, Italisë, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara. Por edhe ata që kanë ngelur, nuk shpresojnë që gjendja do të përmirësohet, por që edhe atyre t'u vijë një mundësi emigrimi. Ata ndihen të pafuqishëm për t'i ndryshuar gjërat dhe çfarë është bërë duket e pandreqshme, njëlloj si kodrat e masakruara të Krastës që nxjerrin kancer nga hundët, siç shprehen banorët e qytetit, ku kanceri, meqë ra fjala, po bën kërdrinë vitet e fundit. Me këtë ritëm, Kruja shumë shpejt do të braktiset plotësisht. Bashkë me të, do të braktiset edhe historia, ndërkohë që bustet dhe basorelievet me portretin e Skënderbeut, zënë vendin e tyre të respektuar në gjithë Europën: në Itali, Belgjikë, Vjenë, bile edhe në Poloni.

competitive pricing relative to domestic agricultural products, leading domestic agriculture to bankruptcy. Therefore, our country's agricultural economy bears the brunt of this. For this reason, everyone hopelessly aims to migrate, where they work other people's lands, rather than their own.

## Retrospective 2

Although not often, every year I go back to the town of my childhood, Kruja, one of the most visited tourist sites in Albania (as stated by tourism guides, at least). Skanderbeg castle, the symbol of resistance to Ottoman rule, the most historic event that led to the recognition of Albania in Europe, is situated there. Kruja is a town with no industry, surviving solely on handicraft, tourism, and scarce apparel companies. Despite its favourable geographic location (36 km from Tirana and 12 km from the international airport), and the significance and generosity of the locals, Kruja is rapidly losing its charm. A group of Slovenian tourists did not go a step further once they saw hills eroded by lime kilns at the town entrance. Holes and smoke. On the other hand, buildings violating against every urban planning standard and bearing witness to failed management over the last three decades, have disfigured the architectural identity of this town; this was a further source of disappointment among visitors.

What are the results? Every time I go back to my dear town, I find fewer familiar faces. Inhabitants consistently migrate to Germany, Italy, UK, and USA. Even those still living in Kruja have lost every glimmer of hope and are waiting for migration opportunities. They feel powerless to change the situation, and it seems like everything is irreversible; much like the eroded hills of Krasta that

## Për një jetë më të mirë

Ishte e pamundur që brenda katër ditëve të këtij udhëtimi, të krijonim një pamje të plotë të dramës së braktisjes së vendit, pasi çdo qytezë ose fshat ka historinë e vet, çdo individ ka përvojën dhe alibinë e tij, por që tani bashkohen në një pikë të vetme: nevojën për të emigruar.

Për Ben Andonin, gazetar me përvojë dhe publicist, i cili ishte guida jonë në këtë udhëtim, nuk kishte asgjë të panjohur. Reputacioni i tij na hap dyert gjithkund dhe falë komunikimit të tij me atë zërin e butë dhe besueshmërisë që krijon rreth vetes, ne mundëm të hynim shumë me thellë se në fshatrat dhe shtëpitë e njerëzve: ne mundëm të hyjmë në historinë e tyre, në mendësinë e tyre, në brengat e tyre, duke parë nga afër atë transformim të pashmangshëm që emigrimi solli në familjen shqiptare.

Christian Filips, i ftuari ynë nga Gjermania, poet, performer dhe aktivist, e njeh emigrimin nga një tjetër këndvështrim: nga komuniteti i emigrantëve në Berlin me të cilin ai bashkëpunon herë pas here dhe që i mbështet. I mprehtë, me kureshtjen dhe ndjeshmërinë e një shkrimtari por edhe të një të huaji, ai pranoi me kënaqësi të bëhej pjesë e kësaj aventure. Por mbi të gjitha, ai është i interesuar të zbulojë se çfarë i shtyn emigrantët, ndër ta edhe shqiptarët, të braktisin trashëgiminë e tyre, një pjesë të identitetit të tyre, për t'u përballur me sfidën e vështirë të integritimit social dhe kulturor në vendin e tij, dhe në vende të tjera.

vomit cancer, as the town inhabitants like to put it. And by the way, cancer rates have dramatically increased over recent years. If this continues, Kruja will be soon completely abandoned as well as its history, while the respected statues and bas-reliefs of Skanderbeg stand across Europe, in Italy, Belgium, Austria, and Poland.

## For a Better Life

Four days did not give us enough time to get a full view of our country's abandonment, for every town or village had its own story, every individual had their own experience and alibi, which all had a common denominator: the need to emigrate.

To Ben Andoni, an experienced journalist and publicist, and our guide on this trip, the situation was nothing new. His good reputation gave us access everywhere and his soft and reliable communication helped us reach the depths of villages and people's lives: we heard their stories, opportunities, worries and concerns, and saw first-hand the inevitable transformation of Albanian families due to emigration.

Christian Filips, our guest from Germany, a poet, performer, and activist, viewed migration from another perspective; that from a migrants' community in Berlin, whom he cooperates with and supports time and again. His intelligence, curiosity and sensitivity as an author and a foreigner led him to join our adventure. Above all, he was interested in finding out what drove migrants, Albanians in our case, to abandon their heritage, a part of their identity, and to be faced with the difficult challenges associated with social and cultural integration in and outside their country.

Vjola Leskaj, fotografe shqiptaro-belge, ka një rol pak më të vështirë në këtë projekt, që është një rol i ndarë midis profesionit dhe nostalgjisë për vendin. Heshtja e respektueshme e Vjolës, thyhet vetëm në fund të ditës, gjatë një darke të përbashkët ose gjatë rrugës së kthimit në makinë. Ajo vetë ka historinë e saj të emigrimit, madje të denjë për një skenar filmi, por që ajo e përshkruan me pak fjalë. Ne arrijmë të kuptojmë diçka nga emocionet e saj vetëm nga gjestet, nga mënyra se si trajton personazhet që zgjedh për të fotografuar. Me sa përulësi hyn në komunikim me ta! Me sa delikatesë dhe dhimbshuri!

Elton Baxhaku, kineasti që është pjesë e këtij grupi, na ndjek gjithkund pa rënë në sy. Ai është krejt i përfshirë në ngjarje, dhe kamera është gjymtyra e tij. Edhe ai i ka shkelur disa herë të tjera më parë këto vende dhe e di se nuk është e lehtë t'i filmosh vendasit në privacinë e tyre, në një kohë kur shumë prej tyre janë skeptikë ndaj televizioneve ose ndjehen të abuzuar prej tyre. Por ai e gjen mënyrën se se t'i bëjë ata të ndjehen rehat në praninë e kameras, aq sa një moment, ata gati e harrojnë se po filmohen.

Sado e planifikuar deri në detajet më të vogla, rru-ga ka të papriturat e saj veçanërisht kur takimet dhe personazhet e këtij udhëtimi janë në dorë të rastësisë. Dhe është Klaudja Zerva, koordinato-rija e këtij projekti, që ka një zgjidhje për gjithçka. E shkathët, me atë energji pozitive që përcjell tek të tjerët, e vendosur dhe miqësore, ajo thjesht e përforcon dyshimin se pse duhet ta braktisë një vend, ku ekzistojnë njerëz të tillë?

Dhe me siguri kjo është edhe pyetja që Christian Filips, i bëri vetes në takimin tonë të parë që ishte me kursantët e gjermanishtes në Qendrën Goethe në Tiranë, shumica të rinj, të zgjuar, mad-

Vjola Leskaj, an Albanian-Belgian photographer, played a challenging role in this project, as she was caught between doing her job and feeling nostalgic about her country. Vjola's dignified silence was only broken at the end of the day, during group dinners or our return home. She was a migrant herself, and her story could be made into a movie, albeit she did not disclose many details. However, her gestures and her care towards the characters she chose to photograph showed her true emotions. She talked to them with such sensitivity and compassion!

Elton Baxhaku, a filmmaker, silently followed us everywhere. He became one with the people we talked to and the camera he used. He had been to these villages before and was aware that it was no mean feat to film locals in their privacy, at a time when many of them felt sceptical or abused by the television world. Nonetheless, he found a way to make them feel comfortable in front of the camera and forget that they were being filmed.

Despite thorough planning, trips can be unpredictable, especially when the meetings and characters they encounter are coincidental. It was Klaudja Zerva, the project coordinator, who had a solution to everything. The active, positive, determined, and friendly Klaudja was simply a reiteration of the question: "Why would one abandon this country, a place where there are still such wonderful people?"

This certainly must have been the question Christian Filips asked himself on our first meeting with smart, funny, and young students learning the German language at Goethe Center in Tirana. "My parents gave me a European name so that it could be easily pronounced. I was a

je edhe me humor. “Mua edhe emrin prindërit ma kanë vënë të tillë që të jetë lehtësisht i shqiptueshëm në vendet e Europës. Pra, që pa lindur, jam llogaritur për emigrant!”- tha njëri prej tyre. Ai djalë, mund të ishte rreth 21-22 vjeç, dhe është e trishtueshme kur e mendon që gjatë këtyre 22 viteve, asgjë e mirë nuk ka ndodhur, asnjë lloj progresi, përderisa plani i tij dhe doemos i familjes vazhdon të mbetet emigrimi.

Por humori i hidhur i tij, pasohet nga një e vërtetë edhe më e hidhur e një tjetër kursanti të gjermanishtes, i diplomuar për drejtësi: “Nuk është puna e varfërisë, por mungesa e drejtësisë në këtë vend. Unë jam i sigurtë që sado që të arsimohem, nuk do të jem në gjendje të gjej punë në vendin im, se këtu tregu funksionon ndryshe!”

Mjafton të bësh një investigim të thjeshtë, për të parë konkretisht se sa pak të rinj apo individë të kualifikuar aplikojnë për vende pune, veçanërisht në sektorin publik, që shkon ndesh me numrin e madh të të papunëve, sidomos të të diplomuarve. Arsyeja është se njerëzit e kanë humbur besimin tek transparenca, konkurrenca reale, pavarësisht se formalisht, në politikat e punësimit janë përshtatur kriteret e Bashkimit Europian. Militantizmi, nepotizmi, konflikti i interesit, dominojnë sektorin publik. Përvoja dhe njohuritë, janë të papërfillshme. Shumë të rinj që kanë studjuar në universitete të mira në botë dhe rikthehen për të kontribuar në vendin e tyre, zhgënjehen nga ajo që gjejnë: ata ndihen të panevojshëm. Në këto kushte, të duket vetja emigrant në vendin tënd. “Ky vend nuk të le të jetosh me dinjitet!”- u shpreh njëri prej studentëve, duke përmledhur me dy fjalë gjithë thelbin e çështjes.

Duke u emocionuar disi, secili prej nesh doli pak prej pozicionit të tij neutral. Beni, duket sikur

migrant before I was even born!” - a 21-22-year-old boy said. It is sad to think that in 22 years, there has been neither progress nor improvement, with migration remaining the only plan for the boy and his family.

Nevertheless, his bitter sense of humor was accompanied by an even more bitter truth told by another law graduate of the German course: “It is not about poverty. It is instead about a lack of justice in the country. I am absolutely certain that no matter what my level of education, I will never be able to find a job in my country, because that’s just how the market works!”

Simple research corroborates the low number of qualified individuals and young people applying for jobs, especially in the public sector; this often contradicts the high unemployment rate, particularly among graduates. The reason is that people no longer believe in real competitiveness and transparency, despite the formal approximation of employment policies to European Union criteria. Militancy, nepotism, and conflict of interest are all prevalent in the public sector. Experience and knowledge are insignificant. A plethora of young people, who studied at the best universities worldwide and return to make their contribution to their country, are let down by what they find: they feel useless. These circumstances make you feel like a migrant in your own country. “It’s our own country that doesn’t let us live in dignity!” - One of the students said, summarising the whole gist of the project.

Each of us got emotional and somehow lost some of our neutrality. It seemed as if Ben was telling them: “Wouldn’t it be better to fix things, rather than leave the country? If not you, then who?” In the same vein, but on a different ar-



u thotë: “A nuk është më mirë të rregulloni këtë vend se sa të ikni? Kush do ta bëjë po nuk e bëtë ju?!” Dhe Christiani, po me të njëjtën keqardhje, por me tjetër argument: “Më besoni, as Gjermania vetë nuk është fushë me lule!”. E fundit unë, më pesimistja nga të gjithë: “Rrugë të mbarë! Në fund të fundit, askush s’ka kohë për të humbur!”

Të nesërmen u nisëm për rrugë, drejt Jugut të Shqipërisë. U ndalëm fillimisht në fshatin Nartë dhe pastaj në fshatin Dukat të Vlorës, njëri pranë detit dhe tjetri në mal, të dy të bekuar me bukuri natyrore por të populluar nga shpirtrat e të ikurve. Dyer të gozhuara, dryrë të ndryshkur, bari që rritet deri tek parvazi i atyre që dikur shërbenin si dritare, dhe njerëzit e paktë për të cilët koha rrjedh shumë avash deri në verë, kur një pjesë e

gument, Christian said: “Believe me when I say that Germany is not a fairytale either!” I was last, the most pessimistic one: “Farewell! After all, no-one has a minute to lose!”

The next day we headed to South Albania. At first, we stopped in Narta village, then in Dukat village, Vlorë. The former is on the coast, the latter is situated among the mountains; both are blessed with natural beauty but populated by the souls of those who left. Nailed doors, rusty locks, grass growing on what used to be windowsills, and few people, who longed for summer to come along with their migrant sons and daughters for their two-week vacation. On the second day, we headed to North Albania, stopping by Rubik mining town, a relic of the bankrupt



bijve dhe bijave emigrante do të kthehen për të kaluar dy javë. Në ditën e dytë, udhëtimi është drejt veriut duke u ndalur në qytezën e Rubikut një nga qytezat minatore, rudimente të industrisë së falimentuar socialiste. Dhe pastaj fshatrat e rrugës për në Shkodër, ku duket sikur asgjë nuk ndodh përveç gjurmëve të afisheve elektorale, të mbivendosura mbi njëra-tjetrën. Ditën e tretë, ndalesat tona ishin në fshatin Obot dhe Torovicë në Shkodër dhe fshatin Adriatik në Krujë. Shkolla të ftohta e të braktisura, shtëpi në shitje por që askush nuk i blen, ata pak të rinj në moshë që kanë mbetur, solidarizohen vetëm në pafuqinë e tyre, duke i ofruar një teke raki njëri-tjetrit në klubin e fshatit. Kthehen në shtëpitë e tyre nëpër rrugët me baltë, disa prej tyre me celularë të markës së fundit në xhep, a thua se zgjidhjet ndodhen brenda atij instrumenti të vogël misterioz, në komunikimin me botën.

Se çfarë ndodh më tej në këtë udhëtim, e rrëfen me detaje Ben Andoni në reportazhin e ij, dhe Christian Filips në një mënyrë tjetër në esenë e tij. Dhe ato çka ne nuk arrijmë t'i shprehim me fjalë, i plotësojnë fotografitë e Vjolës dhe pamjet filmike të Eltonit. Vende befasuese në bukurinë e tyre, dhe për paradoks shumë dramë dhe pak shpresë. Njerëz që duken sikur nuk i kanë më fatet e tyre në dorë, sikur e kanë humbur shansin e tyre historik.

Duke u kthyer drejt Tiranës, është e pamundur të të shpëtojë pamja e shtëpive të reja dy-katëshe apo tri-katëshe apo shtëpive të papërfunduara akoma, të cilave vitin tjetër do t'u shtohet edhe një kat. Dritat e tyre janë të fikura. Janë shtëpitë që ndërtojnë emigrantët për vete, janë kursimet e një jete punë, me shpresën që herët apo vonë do të kthehen bashkë me familjen, edhe pse, ne e dimë, që e gjitha kjo është një ëndërr e vakët.

socialist industry. On our way to Shkodra, we visited some villages, where it looked like nothing had progressed, apart from some election posters overlapping one another. On the third day, we went to Obot and Torovica villages in Shkodra, and Adriatic village in Kruja. Cold and abandoned schools, homes for sale never to be purchased, and the few young people left were only united by their powerlessness, offering one another a shot of raki <sup>2</sup>at the village coffee shop. They returned home walking on muddy roads, some of them with the latest smartphones in their pockets, as if those small mysterious communication devices would solve every problem.

What happened next on our trip has been narrated in detail by Ben Andoni in his report, and conversely by Christian Filips in his essay. What we could not put into words has been complemented with photographs captured by Vjola and videos shot by Elton. Breathtaking villages, filled with drama and faint hope. The fate no longer appears to be in people's hands, who seemingly lost their once-in-a-lifetime chance.

En route to Tirana, we could not help but notice the new two-three-storey houses or unfinished homes, waiting to be fully constructed the following year. Their lights were off. They were the homes that migrants built for themselves, with their own savings and the hope that sooner or later, they will return with their families. Although we know this is a dream that will never come true.

---

2. *Translator's note: A traditional Albanian distilled alcoholic beverage; moonshine.*



# NJERËZ, JO FANTAZMA. NJË UDHËTIM NË “FSHATRAT FANTAZMË” TË SHQIPËRISË

THESE ARE PEOPLE, NOT GHOSTS.  
A JOURNEY TO THE ALBANIAN “GHOST VILLAGES”

CHRISTIAN FILIPS

1.

Prill, 2017

Jam ulur me Nertilën në një bodrum në Beusselstrasse të Berlinit. Këtu në këtë “Kegelbahn” të dalë jashtë pune prej kohësh, i cili qe ndërtuar më shumë se pesëdhjetë vjet më parë nga shoqatat e punëtorëve të ish-Lagjes së Kuqe, sot, të sapoardhurit, të mërguarit, refugjatët nga e gjithë bota takojnë banorë të zonës të vendosur këtu prej kohësh. Lagja e re “Moabit” është një vend i mahnitshëm që nuk përshtatet në imazhin e metropolit të zhvilluar. Kudo në Berlin, hendeku midis klasave shoqërore po thellohet, shtresat po bëhen më të padepërtueshme. Por në këtë bodrum, i cili duket si një stacion metroje ku nuk ndalon asnjë tren, ndryshimet mund të harrohen për disa orë më lehtë sesa kudo tjetër. Në këto ambiente të rrënuara fshihet një projekt

1. Pistë për lojë birila

1.

April 2017.

I sit with Nertilë in a cellar on the Berliner Beusselstraße. Here, in this bowling alley that has been out of use for some time, which was built more than 50 years ago by workers’ associations of the former Red District, is a place where newcomers, exiles and refugees from all over the world now encounter long-established residents from the neighbourhood. The “new neighbourhood of Moabit” is an astonishing place and seems incongruous with the image of a gentrified metropolis. Everywhere in Berlin, social classes are drifting apart and becoming increasingly impenetrable. But in this cellar, which looks like an underground station where trains no longer stop, it is easier than anywhere else in the city to forget these differences for a while. These derelict rooms harbour a social project, but also a pub, an art studio, and a language school.

social, por edhe një lokal, një studio arti, por edhe një shkollë për gjuhë. Kur hapa derën për herë të parë, pas disa minutash anëtarët e opozitës siriane më përshkruan dinamikën e brendshme të Pranverës Arabe të dështuar. Me birrën e dytë u bëra me fqinj të rinj, me të dhjetën kisha bërë tashmë miq të rinj.

Nertila ka ardhur këtu nga Alpet Lindore Shqiptare. Ajo më tregon për jetën e saj të kaluar. Për mësuesin e fshatit me syrin e një dhie që qan. Për gurin, hija e të cilit i shërbente si orë kur kulloste delet në male. Për martesën e saj të detyruar në moshën 15 vjeçare. Për burrin që e rrihte dhe për dëshirën për të qenë një re ose një zog. Ndërkohë, vizitat e shumta tek autoritetet në Berlin i zgjojnë mallin për vendlindjen. Në smartphone-in tim, i tregoj Nertilës një poezi shqipe nga Luljeta Lleshanaku, të cilën e mbaj me vete prej disa vitesh. Mbi të gjitha, vargjet hapëse më mbetën në mendje. Teksti quhet "Realitete vertikale" dhe fillon me një imperativ të ngjashëm me atë që gjendet këtu në Berlin mbi gurin e varrit të filozofit Herbert Marcuse:

*„Të vazhduarit, në rastin tim, nuk është zgjedhje por detyrim qëkur tri breza zgjohen njeherazi brenda meje.“*

Kur e lexoj përsëri poezinë, vërej se aty nga fundi mbetet e hapur se kush duhet të vazhdojë në të vërtetë: Të gjallët apo të vdekurit. A është vërtetë *uni* që i vë vetes detyrë për të vazhduar më tej? Apo mos janë më tepër paraardhësit e vdekur ata që vazhdojnë dhe i përdorin të gjallët si një palë doreza plastike në mënyrë që të mos lënë gjurmë në skenën e krimit?

Po vërtet! *Uni* është skena e krimit në këtë poezi. Në të ka gjurmë që mund të jenë vendosur tashmë por nuk janë lexuar ende. Ajo që u la si gjurmë në të kaluarën mund të rezultojë vërtetë

As I stepped through the door for the first time, Syrian opposition members spent a few minutes enlightening me about the inner dynamics of the failed Arab Spring. By the time I was on my second beer I had a new neighbour and had already made new friends when I reached my tent.

Nertila came here from the Eastern Albanian Alps. She tells me about her former life. Of the village teacher with an eye like a crying goat. Of the stone whose shadows helped her tell the time at the shepherd's hut in the mountains. Of her forced marriage at 15 years old. Of her violent husband and of her wish to be a cloud or a bird. The many visits to authorities in Berlin now evoke a sense of homesickness, however. On the Smartphone I show Nertila an Albanian poem by Luljeta Lleshanaku that I carried around with me for some years. Particularly the introductory verse remains etched in my memory. The text is called "Vertical Realities" and starts with an imperative, which is similar to that found here in Berlin on the gravestone of the philosopher, Herbert Marcuse:

*„Të vazhduarit, në rastin tim, nuk është zgjedhje por detyrim qëkur tri breza zgjohen njeherazi brenda meje.“*

In the translation by Andrea Grill:

*"You just have to keep going, every morning three generations open their eyes in me."*

When I read the poem again, I realise, the end does not betray who should keep going: The living or the dead. Is it really the self who imposes this duty to carry on? Or is it rather the undead ancestors, who never cease to continue and "use the living like a pair of plastic gloves so as to leave no traces behind at the crime scene"?

Yes indeed! The self is the crime scene in this

si gjurmë në të ardhmen në të cilën do të lexohet. Mos më bëri kaq shumë përshtypje poema ngaqë paraardhësit e mi vijnë gjithashtu nga Ballkani? Bački Jarak, Vojvodina, Shvabët e Danubit, Dora e Zezë. Kujtesa ka boshllëqe.

Mirëpo ky moment i tronditjes së përditshme më kishte mbetur në kujtesë: qysh në mëngjes, me të pulitur sytë, të gjithë paraardhësit qenë mbledhur buzë shtratit. Çfarë ceremonie incestuale varrimi për mëngjes!

Megjithatë, Nertila u entuziasmua nga poezia dhe e kopjoi atë për të mësuar fjalorin. Kështu lindi plani për ta ftuar poeteshën e panjohur për ne që të bënte një lexim për komunitetin shqiptarokosovar në lagjen e re. Plani mori udhë gjashtë muaj më vonë. Me ndihmën e Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë, ne arritëm të joshnim Luljeta Lleshanakun në Berlin për një lexim. Opozita siriane kishte përkthyer “Realitete Vertikale” në arabisht për mbrëmjen. Dhe kështu, në vjeshtën e vitit 2017, thirrja ambivalente e paraardhësve: “Të vazhduarit është detyrim!” tingëlloi në mëngjes në lagjen e re në shqip, arabisht dhe gjermanisht. Të gjithë dukej se u çliruan nga zgjimi i paraardhësve të tyre përkatës. Ishim ne që cikëm botën atë mbrëmje, qëndruam gjatë zgjuar dhe festuam jetën si re dhe zgj.

2.

Tetor 2019. Pak pas uljes së avionit në Tiranë, policja shqiptare që ishte ulur pranë meje në aeroplan tha se sapo ishte kthyer në shtëpi nga një seancë trajnimit policie në Alaskë.

“E çfarë të sollti në Shqipëri?”

I shpjegoj se kam pranuar ftesën e një poeteshe dhe të Fondacionit Konrad Adenauer, të cilët duan të më dërgojnë në të ashtuquajturat “fshatra fantazmë” të Shqipërisë. Nëpunësja e

poem. There, traces can be found that have perhaps already been laid, but not yet found. That which was laid as a trace in the past, can only prove to be a trace from the future in which it is read. Did the poem have such a strong impact on me because my forbears came from the Balkans? Backi Jarak, Vojvodina, Danube Swabians, Black Hand. The memory is blurred.

But this moment of day-to-day shock remained in my memory: immediately in the morning, with the first blink of an eye, all ancestors gathered around the edge of the bed. What an incestuous funeral feast for breakfast!

Nertila was still inspired by the poem and wrote it down to learn the vocabulary. That’s how the idea came about to invite the poet, unfamiliar to us, for the Albanian/Kosovo community to the new neighbourhood and to do a reading with us. One year later, the plan came to fruition. The international literature festival made it possible for us to entice Luljeta Lleshanaku to Berlin for a reading. The Syrian opposition members had translated “Realitete Vertikale” into Arabic for the evening. And so, in Autumn 2017, our new neighbourhood resounded with the sound - in Albanian, Arabic and German - of this ambivalent appeal from our forebears in the morning: “You just have to keep going!” Everyone seemed to be present in spirit, freed from their respective ancestors in the blink of an eye. It was us who, on this evening, reached for the world, stayed awake a long time and celebrated life, as clouds and birds.

2.

October 2019. Shortly after landing in Tirana, the Albanian policewoman, who sits next to me on the plane, recounts how she just returned home from police training in Alaska.

“And what brings you to Albania?”

shtetit buzëqesh dhe më jep kartëvizitën e saj: “Bëni diçka të bukur për vendin tonë!”

Diçka të bukur? A mos më konsideron një investitor që mund të ringjallë fshatrat e braktisura malore përmes projekteve të ujditura ekonomike? Fus kartëvizitën dhe them: “Nëse fantazmat në male na krijojnë probleme, tani kam kontakt të drejtpërdrejtë me policinë shqiptare”. Ajo qesh teksa zbresim së bashku nga aeroplani. Jashtë, një shofer taksie mban një tabelë me emrin tim. Përmes rrugëve hyrëse të Autostradës së Durrësit shkohet shpejt në qendër të qytetit, kalon Pallatin Amadeus, një simbol arkitektonik i post-komunizmit Ballkanik. Ky sfond pompoz në hyrje të qytetit është një përzierje hoteli dhe kazinoje, i përfunduar qysh në vitin 2016 dhe që nuk është hapur ende sot, një simbol për tregun e zi, pastrimin global të parave dhe shitjen e një vendi.

Dy orë më vonë, takoj përsëri Luljetën në Institutin Goethe me studentë të rinj që duan të mësojnë gjermanisht. Të gjitha kurset e gjuhës janë plotësisht të mbipopulluara. Ashtu si Nertila, shumica e tyre dëshirojnë të largohen nga vendi, të paktën përkohësisht. Disa prej tyre vinin nga fshatrat malore në qytet. Kur flasim për imazhin që kanë për Gjermaninë, një e re thotë se gjithçka është e organizuar mirë atje. Shumë flasin për hyrjen falas në shkolla dhe universitete, për cilësinë e sistemit të sigurimeve. I pyes nëse lidhin ndonjë aspekt negativ me Gjermaninë. Djali i një rrobaqepësi i cili ka punuar për një *Callcenter* gjerman tregon se gjermanët ndihen të vetmuar dhe nuk flasin me fqinjët e tyre. Ai e njeh aq mirë psikikën gjermane, sepse tashmë e ka njohur atë nga afër si punonjës në *Callcenter*. Ai është i vetmi që nuk ka ndërmend të emigrojë. Ai thjesht dëshiron të fitojë sa më shumë para dhe pastaj të kthehet te prindërit e tij. Kur i pyes me radhë nëse ndihen evropianë, një djalë thotë

I explain how I accepted the invitation of a poet and the Konrad Adenauer Stiftung, who want to give me a tour of the so-called “Ghost Villages” of Albania. The civil servant smiles and hands me her business card. “Make our country into something beautiful!”

Something beautiful? Does she consider me an investor, who can use smart economic projects to breathe life back into abandoned mountain villages? I accept the business card and say: “In case the ghosts in the mountains give us any problems, I now have a direct contact for the Albanian police”. She laughs as we disembark the plane.

Outside, a taxi driver holds up a sign bearing my name. We soon raced over the main streets of Durres highway in the direction of the city centre, past Amadeus Palace, an architectural symbol of Balkan post-communism. This grandiose backdrop at the gates of the city, is a mix of hotel and casino, for which building was completed in 2016 and has still not been opened. This is emblematic of black-market trading, global money laundering and the sell-off of a country.

Two hours later in the Goethe Institute I encounter Luljeta again, in the circle of young students, who would like to learn German. All language courses are completely jam-packed. Like Nertila, most of them want to leave their country, at least for a while. Some of them came from villages nestled in the mountains to the city. As we talk about her image of Germany, a young woman says that everything is well organised there. Many speak of free access to schools and universities, from the quality of the insurance industry. I ask whether they also connect Germany with negative aspects. The son of a tailor, who worked for a German call centre, reports that Germans feel lonely and do not speak to their neighbours. He is particularly familiar with the German psyche because he got to know it well while working as an employee at a call centre. He

se kjo është një pyetje e modës së vjetër. Në fund të fundit, të gjithë janë qytetarë të botës tani. Dhe shton se Shqipëria natyrshëm i përket Evropës, nga ana kulturore dhe gjeografike. Me krenari thotë fjalën “Iluminizëm” dhe shton: “Shqipëria dikur ishte shteti i parë ateist në historinë botërore”.

Natën më oshëtijnë veshët. Banoj fare pranë xhamisë së madhe Namazgja, e cila është në ndërtim e sipër. Ajo do të bëhet xhamia më e madhe në Ballkan, financuar nga Erdoğan dhe Fondacioni i tij fetar Diyanet Turqi. Është 28 gradë gjatë natës këtë tetor.

Të nesërmen në mëngjes nisemi herët për në male, në të ashtuquajturat fshatra fantazmë. Por fillimisht shkojmë drejt jugut, përgjatë bregdetit Adriatik, ku shfaqen të parët dhe, siç del më

is therefore the only one who doesn't plan to emigrate. He aims to earn as much money as possible and to then return to his parents. When I pose the question whether they feel European, one boy comments on how this is an outdated question. Ultimately, they're now all global citizens. He adds by saying Albania of course belongs to Europe, both culturally and geographically. It is with pride that she utters the word “enlightenment” and adds: “Albania was once the first atheistic state in world history.”

At night, I hear a ringing in my ears. I live directly next to the colossal Namazgja mosque, that is currently being built. It is to be the largest mosque in the Balkans, financed by Erdoğan and his religious Diyanet-Stiftung Türkei. This October, the temperature at night-time is 28 degrees.



vonë, të vërtetët “fshatra fantazmë”. Skelete rrokaqiejsh, skelete hotelesh të larta qarkojnë bregdetin, gjysma ende në ndërtim e sipër, gjysma rrënojë investimi. Këtu jetojnë fantazmat që ëndërronin biznes të madh me turizëm masiv që nuk do të vijë më. Natën enden qentë nëpër këto lagje të braktisura.

Duket ndryshe kur mbërrimë në një fshat të vogël peshkimi, në të cilin jetojnë kryesisht pjesëtarë të pakicave greke. Në sheshin e vogël të tregut ka shumë gjallëri. Ndryshe nga shumica e fshatrave në Brandenburg, kafeneja është hapur. Na shërbejnë, ka edhe njerëz, të cilët mund t’i pyesim se ku jetojnë shpirtrat këtu. Madje është edhe i çmenduri i mençur që bën pjesë në jetën e pacënuar të fshatit. Ai na lëshon me të bërtitur ca rrokje greke, fjalë të urta sokratike që mbase duhet të na trembin. Na tregojnë një rrugicë të shkretë disa qindra metra larg, në fund të “rrugës së karnavalit”. Dikur këtu kishin banuar shumë familje peshkatarësh grekë. Kur munden, të rinjtë migrojnë në Greqi. Është ikja e zakonshme nga fshati, sikurse në të gjithë botën. Në njërën prej shtëpive jeton edhe një burrë i moshuar, ndoshta 90 vjeç, i cili bën vetë raki, ua shet fqinjëve dhe fiton kështu ato pak para që i duhen për të jetuar. Fëmijët janë në Selanik dhe punojnë atje. Ndonjëherë vijnë dhe sjellin para në shtëpi. Unë e admiroj krenarinë dhe pirjen e zotërisë së moshuar, i cili këtu di ta ruajë dinjitetin e tij shumë më mirë sesa në një nga shtëpitë e të moshuarve gjermanë, ku nëna ime strapacohet si kujdestare. Distiluesi për raki përbën qendrën e shtëpisë së vogël, një lloj altari shtëpie. Meqenëse plaku ankohet për dobësimin e syve, edhe unë kam frikë se kjo pije me përqindje të lartë alkoli mund të çojë në verbëri të shpejtë dhe e derdh gotën e dytë pas shkurren si kurban për të gjithë shpirtrat e atyre që nuk jetojnë më këtu.

Prej këtij fshati shkojmë në male, në një fshat







The next morning, we head off early, into the mountains, to the so-called ghost villages. At first, we travel south, along the Adriatic coast, where the first, and as we will later see, the real “ghost villages” can be found. Shells of former high-rise buildings, skeletal hotel palaces line the coast, half still under construction, half investment ruin. Here is where the ghosts live, who dreamt the dream of big business with mass tourism, which will no longer come true. At night dogs roam about through the desolate districts.

The picture is a different one when we arrive at a small fishing village, where mainly members of Greek minorities live. The marketplace is a scene of hustle and bustle. Unlike most villages in Brandenburg, the Kafenio is open. We’re entertained and people are there who we can ask where the ghosts live. There’s even a wise madman, who is a common feature of any intact village. He shouts Greek syllables at us, Socratic proverbs, that are perhaps supposed to instil fear in us. Someone shows us an abandoned alley, a few hundred metres in the distance, at the end of “carneval street”. This was the dwelling place of many fishing families in years gone by. If they are able to do so, young people emigrate to Greece. It is the usual village flight that we witness all over the world. An old man still lives in one of the houses, perhaps 90 years old, who burns his own Raki and sells it to his neighbours to earn a bit of money, which he needs to survive. The children are in Thessaloniki and work there. Sometimes they stop by and bring money home. I admire the pride and drunkenness of the old man, who is better placed here to uphold his dignity than in a German retirement home, where my mother slaves away as a carer. The distillery device for the schnapps forms the heart of the small house, a type of temple in the house. Given that the old man complains about deteriorating eyesight, I, too, worry that this high percentage



malor plot gjallëri. Edhe këtu kafeneja është e hapur. Edhe këtu ka një xhami dhe një kishë. Edhe këtu, na mirëpresin ngrohtësisht dhe u përgjigjen pyetjeve të mia në lidhje me traditat e këndimit koral polifonik. Pastaj na drejtojnë në një shteg të pjerrët deri tek më e moshuara e fshatit, e cila jeton këtu prej shumë vitesh, tjerr leshin dhe na këndon një këngë të vjetër në një mënyrë që të këput shpirtin. Unë nuk njoh të moshuar të tillë të lumtur në provincat gjermane. Jam plotësisht i hutuar kur gjatë kthimit për në shtëpinë e fshatit, drejt nesh vjen një autobus nga i cili mbërrijnë ndoshta njëzet nxënës shkolle. Ky na qenka fshat fantazmë? Nëse krahasoni strukturat rurale në Gjermaninë Lindore me ato në Shqipëri, bëhet e qartë se strukturat e vjetra të fshatrave janë shumë më të paprekura këtu. Dhe këtu e kam fjalën jo vetëm për shfrytëzimin e pronës, por edhe për shëndetin mendor të

brew could soon lead to blindness and gingerly tip the second glass behind a bush, as a libation for all the other ghosts who no longer live here.

From this village we head towards the mountains, to a vibrant mountain village. The Kafenio is open here as well. Here there is a mosque and a church. Here we also received a warm welcome and, at my instigation, are told about the traditions of the communal, polyphonic choral singing. We are then led up a steep path to the village elder, who has lived here many years, spins her own wool, and sings a heart-rendering old song. I'm not familiar with old people who are so happy in the German provinces. I stand there completely perplexed when, on the way back to the village house, a bus approaches us from which some twenty school children alight. Is that supposed to be ghost village? If we compare the rural structures of East Germany with those in Albania, it becomes clear that old village



banorëve. Përshtypjet e mia përsëriten edhe në ditët në vijim, edhe gjatë udhëtimeve në veri të vendit. Askund nuk ka dyshim për mysafirët e huaj, të gjithë mikpritësit të japin raki me bollëk. Nacionalizëm nuk kam ndeshur askund. Varfëria relative dhe nevoja për të jetuar në mënyrë të pavarur nga ndikimi i arbitraritetit politik me sa duket nuk i ka përkulur këta banorë rural, por përkundrazi u ka dhënë një autonomi të caktuar. Në një qytezë të vogël që karakterizohet nga puna në miniera, na mirëpret një çift i vjetër. Kur unë, duke qëndruar para pemës së shegës prek një nga frutat e bukura, e zonja e shtëpisë nxiton dhe e pyet përkthyesen: “Ka uri? Kemi kaq shumë shegë! Mund t’i marrë të gjitha!”

Të thyer duken vetëm të rinjtë në qytete dhe qyteza. Peshkatarët e përhumur nga gjuajtësit me dinamit në bregdet. Minatorët e papunë në qytetet e braktisura të minierave. Sa më urbane

structures are far more intact here. And with that I not only mean the affordability of property, but also the inhabitants’ emotional well-being. My impressions are reinstated during the following days and even during trips to the north of the country. Nowhere is there suspicion about foreign guests, all hosts pour plenty of home-made spirits. Nowhere have I encountered a sense of nationalism. Relative poverty and the need to live independently of political arbitrariness apparently did not suppress these rural dwellers, but rather gave them a degree of autonomy.

In a small town that is shaped by mining, we are greeted by an old married couple. As I stand in front of the pomegranate tree and grasp one of the most beautiful fruits, the owner of the house hurries over and asks the translator: “Are you hungry? We have so many pomegranates! He can take them all!”

të jenë strukturat, aq më të mjera janë kushtet. Pra, fantazmat nuk jetojnë në fshatra. Fantazmat jetojnë në kështjellat turistike të boshatisura në bregdet. Jetojnë në banesat sociale që regjimi Hoxha i ndërtoi dikur për t'u mundësuar njerëzve një jetë më të mirë përtej fshatrave. Tani, sistemi shoqëror që krijoi këto ndërtesa është zhdukur prej kohësh. Të moshuarit dhe të sëmurët shikojnë në mure fotografitë, të cilat tregojnë shtëpitë e prindërve të tyre në fshatrat malorë ose fëmijët e tyre të emigruar që janë diku në Gjermani për të fituar para për familjen.

Një burrë në një qytezë të vjetër minierash gëzohet jashtëzakonisht nga vizita jonë. Ai nxjerr menjëherë celularin, telefonon në Skype dhe më lidh me djalin e tij, i cili jeton në një periferi të Berlinit Lindor. Ai me të drejtë më shikon me skepticizëm në distancat e hapësirës dixhitale. Në ndryshim nga i ati, ai dyshon të jem një përfaqësues i pushtetit shtetëror, ndonjë mbikëqyrës apo kontrollues. Por me gotën e rakisë në dorë dhe referencën për poezitë e Luljetës, arrij ta qetësoj dhe të kemi një bisedë të shkurtër. Ai thotë se është në Gjermani vetëm për të bërë para. I riu duket të ketë me të vërtetë sukses. Sepse djali i ka blerë për familjen të gjitha apartamentet në këtë ndërtesë të përbashkët. Si të gjithë të rinjtë që kanë punuar në Gjermani, atë e shqetëson çështja e punës ilegale dhe e së drejtës për të qëndruar.

Të gjithë të rinjtë me të cilët flas kërkojnë që Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian në mënyrë që ata të legalizojnë punën që kanë bërë për vite me radhë. Shumica e tyre hyjnë ilegalisht, punojnë dhe fitojnë para për familjet, pastaj dëbohen dhe presin në fshatrat e tyre derisa të shfaqet mundësia tjetër për të hyrë në Gjermani. Kjo nxitje e krimit duhet të ndalet. Në interes të këtyre të rinjve, Shqipëria duhet të anëtarësohet në Bashkimin Evropian sa më shpejt të jetë e

Only the younger people in the cities and small towns appear broken. Those coastal snail fishers afflicted by dynamite fishing. The unemployed miners in the abandoned mining towns. The more urban the structures, the poorer the conditions. Ghosts don't dwell in the villages. Ghosts live in the vacant tourist centres along the coast. They live in the cooperative social housing once established by the Hoxha regime to enable people to live a better life beyond the villages. The social system, which created these buildings, has now long since disappeared. The elderly and sick stare at photos on the walls depicting their childhood homes in mountain villages, or their children who emigrated and now live somewhere in Germany to earn money for the family.

A man in an old mining town is delighted about our visit. He immediately gets out his mobile, calls Skype and connects me with his son who lives in an East Berlin suburb. Quite understandably, he weighs me up with a sceptical look through the distance of digital space. Unlike his father, he suspects me to be a representative of the state, some kind of inspector or controller. But the Raki glass in my hand and the reference to Luljeta's poem help to reassure him, and we have a brief discussion. He says that he is only in Germany to make money. The young man seems to succeed at this. After all, the son bought all apartments in the former cooperative house for his family. Like all young people who have worked in Germany, he is no stranger to the problem of illegal employment and the right to remain.

All young people with whom I speak, call for Albania's accession to the European Union in order to legalise the work they have been doing for years anyway. Most of them enter illegally, work and earn money for their families, are then deported, and wait around in their villages until the next opportunity for entry presents itself. This incitement to

mundur. Për shkak të së vjetrës, dikush mund t'i trembet anëtarësimit: A do t'i shkatërrojnë tregjet e reja strukturat e fshatit që ekzistojnë ende? A do t'i ndalohet peshkatarit të vjetër grek ta bëjë vetë rakinë e tij? Por këto frikëra janë përfundimisht nostalgjike sepse errësojnë faktin se Bashkimi Evropian nuk mund të shpëtohet pa Shqipërinë. Edhe vetëm për arsye kulturore, është koha të mirëpresim një vend evropian në fshatrat e të cilit myslimanët dhe të krishterët kanë jetuar së bashku për shumë vite. Dhe kjo, jo si një utopi fantazmë, por fare konkrete. Pse të nënshkruajmë një pakt amoral politik me diktatorin Erdoğan kur Shqipëria mund të jetë një vend në "fshatrat fantazmë" të të cilit refugjatët e luftës jo vetëm që mund të gjenin strehë por edhe pjesë të identitetit të tyre kulturor? Përse Bashkimi Evropian nuk vendos thjesht ta përfundojë vetë ndërtimin e Xhamisë Namazgja? Pallati Amadeus mund të bëhet një qendër ndërkulturore. Dhe të ashtuquajturat fshatra fantazmë të Shqipërisë shpejt do të mbusheshin me më shumë njerëz dhe shtëpitë e boshatisura do të gjallëroheshin. Fqinjë më të mirë se ata që tashmë jetojnë atje është e vështirë të imagjinohen.

3.

Nëntor, 2020. E pyes Nertilën nëse do të dëshironte të kthehej dikur në fshatin e saj në male, nëse kjo do të ishte sërish e mundur. Apo nëse tani e sheh Berlinin si shtëpinë e saj të re. "Po sigurisht, ne të gjithë dëshirojmë vazhdimisht të kthehemi në shtëpi! Por a do të duronim gjatë po të ishim përsëri atje?" "Kjo shtëpi nuk duron dot një qen", citoj një varg nga Elke Erb. Nertila më shikon dhe më thotë: „Të vazhduarit, në rastin tim.“

criminality needs to come to an end. In the interests of these young people, Albania should join the European Union as soon as possible. There may be qualms about this accession due to the elderly: Will the new markets destroy the still existing village structures? Will the old Greek fisherman be prohibited from distilling his schnapps? Yet, these fears are ultimately nostalgic because they obscure the fact that the European Union needs Albania to survive. For cultural reasons alone, it is high time to include a European country in whose villages Muslims and Christians have long lived peacefully with one another. And this should not be a ghostly utopia, but a specific road map for the future. What is the point in concluding an immoral pact with the dictator Erdogan when Albania has the potential to become a country in whose "ghost villages" war refugees may not only find shelter, but also rediscover part of their cultural identity? Why does the European Union not decide to finish building the Namazgja mosque itself? The Amadeus Palace could transform into a cultural centre. This way, Albania's so-called ghost villages would soon fill up with other people and revive the vacant houses. It is hard to imagine better neighbours than those who already live there.

3.

November 2020. I ask Nertila whether she would like to return to her village in the mountains one day if that were possible. Or whether she now considers Berlin to be her new home. "Why yes of course, we all want to return home! But can we bear it once we have returned?" "No dog can dwell in this house", I quote a verse from Elke Erb. Nertila looks at me and says: „Të vazhduarit, në rastin tim.“



# PËR TA ËSHTË GJITHMONË DJE!

FOREVER STUCK IN YESTERDAY!


BEN ANDONI

Përditmëria e njerëzve tanë sot t'flet me sytë e mpirë dhe t'shikon me gojën e mbyllur. Pak e vështirë nëse sytë do të arrijnë të flasin atë që zemra u kërkon kurse goja të tentojë të hapet pak më shumë. Tashmë, kjo është e vështirë. Këto besojmë se dimë, ne, një grup syresh njerëzish të profesioneve të ndryshme kah një udhë në kuadër të projektit “*Ghost villages-The unusual potential of the Albania*”, realizuar me shumë përkushtim nga KAS-i. Kjo njësi mikse shqiptarësh dhe të huajsh, brezash të ndryshëm mundohen të përjasin atë që evropianët e marginalizuar në këtë cep të Evropës, sot e njohur me konceptin “Evropa Juglindore” e shikojnë të lidhur me kontinentin e tyre të vjetër, dashurinë e tyre të humbur. Më saktë të pamundur. Udhëtimi ynë nuk do të prekë thjesht braktisjen apo ikjen, por do të përpiqet të qëndrojë atje nga ku edhe nostalgjia ka fëruar në emër të mbijetesës dhe shpresës

Our people's everyday lives speak with numb eyes and stares with mouth shut. A bit difficult if eyes would manage to say what their heart commands, while the mouth could try to speak more. It is hard now. This is what we believe we know, we, a group of people from various professions heading on a journey as part of the “*Ghost villages-The unusual potential of the Albania*” project, which was realised by KAS with high levels of commitment. This mix of Albanians and foreigners from different generations attempt to compare how the marginalised Europeans in this corner of Europe, now known as “South-eastern Europe”, view their lost love with respect to the old continent. It is impossible, to be more precise. Our journey will not only face the abandonment or leaving, but will also attempt to stay there, for which even nostalgia has died away in the name of survival and the hope to leave. Shifting away from this, the rather pathetic essay “*Albania - The*

për të ikur. Për t'u larguar nga kjo, instinktivisht të vjen ndërmend eseja disi patetike "Shqipëria-kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore". Më shumë si digresion. I ndjeri Konica në zakonin e tij të beftësisë dhe pastaj lënies nuk e shkroi të plotë, por e la në mes, kur mori përgjigje negative nga botuesi. Nostalgi? Po edhe ai vetë iku për të mos u kthyer më. Ky ravgim është i tepërt, e ashtu si ndodh shpesh me gjërat që vinë rastësisht, ikin dhe fshihen diku për të ardhur sërish atëherë

*Rock Garden of Southeastern Europe*" instinctively comes to mind, rather as a digression. The late Konica, in his habit of abruptness and quitting did not finish his writing but abandon it halfway when rejected by the publisher. Nostalgia? Well, he also left never to return. Such rambling is excessive, and as it often happens with such circumstantial thoughts, they disappear and hide somewhere only to reappear when least expected. In fact, when preparing for a tranquil business trip, what most often comes





kur se pret. Në fakt, kur përgatitesh të nisësh për një udhëtim të paqtë pune gjërat që të shkojnë më së shumti ndërmend është si të përshtatesh me grupin dhe mbi të gjitha sesi ta nxjerrësh më të mirën e mundshme. Gjithçka duket mirë. Madje, më të ngeshmit mund ta quajnë edhe ekskursion. Mendimet shkërbejnë fjalët e thëna kuturu dhe kthehen te e përditshmja kurse bisedat e zakonshme thjesht e ngasin ditën me njëtrajtshmërinë e zakonshme. Të huajt e shkrirë

to mind is how to best fit into the group, and above all how to show your best self. Everything seems fine. The more relaxed ones may even consider it an excursion, as it happens. Thoughts haphazardly revolve around words and then focus on daily life, whereas ordinary conversations simply drive the day towards its usual uniformity. The foreigners try to fit in and take their time to understand Albanian symbolism, of the country, of the home. Luli explains their essence by employing art canons. Indeed,



normalisht me grupin mundohen të puqen dhe ngeshëm duan të kuptojnë simbolikat shqiptare. Të vendit. Të shtëpisë. Luli ua shpjegon thelbësisht me ndihmën e kanoneve të artit. Në fakt, natyra, koha, njerëzit duket se nuk përputhen, por jeta dhe e përditshmja është kudo njësoj. Dhe, jo më kot, edhe udha e gjatë që çan në një stinë gati pranvere e shkrin dhe e bën të gjithën edhe më monotone. Duket sikur të gjithë duan të harrojnë diçka. Të përditshmen. Të shkuarën. Të ardhmen. Ka shumë artistë në grup por edhe njerëz të profesioneve të tjera, e mbi të gjitha kërkues që rreken të gjejnë sesi ngjan te shqiptarët *dëshira* e ikjes dhe harresa. Sinonimet që kemi dëgjuar dhe ato që na vinë ngërthehen lodhshëm. *“Rruga e tyre për në Evropë nuk është më një romancë. Tani slogani i ri është ‘rruga drejt normalitetit’, shkruan Svetlana Boym, tek “The Future of Nostalgia”, një libër që i afrohet disi turbullimit tonë.*

Po si e përballin vetminë, të mbeturit, pyet një nga grupi. Vajza fotografe, belgo-shqiptare, reagon instinktivisht. Do të flas diçka. Por, duket se gjuha, mosha por edhe matura e pak-mëshershme e ndal. Është pak a shumë e brezit që u largua pas 1997. Nga tragjizmi ynë agresiv. Kujtojnë një mike nga Sarajeva, që më thoshte dikur e trishtuar rrugëtimin e vet evropian. *“Më pyesin vetëm për masakrat. Edhe kur dua t’i iki e u them më lini rehat, këta veç ma kujtojnë. Kujtojnë se ne jemi të lidhur vetëm me tragjizmin”.* Këtë ndjesi duhet ta ketë edhe vajza jonë e heshtur e grupit. Në fakt, neve jemi tragjikë jo prej faktit dhe gjendjes por asaj që na ofrojnë gjithmonë kohërat. Destini? Ku ta dish! Pak muaj më parë kuriozitetin e evropianëve të saj për emigrantët dhe dëshirën e pareshtur të së ashtuquajturës Botë e Tretë (*Sot quhen me eufemizëm Vendet në Zhvillim*) dhe turmës drejt Gjermanisë, kancelarja e hekurit Merkel e zgjidh në dukje thjeshtë: *“Wir schaffen das!”*. *“Po çfarë thua, moj kurvë, ruspie e çmendur, “Volksver-*

nature, time, and people do not seem to match, but life in general and the everyday life is the same wherever you go. And it is not in vain that the long road presses forward in a quasi-spring season, and merges with it to make it all the more monotonous. It seems as if we all wish we forgot something, such as the everyday life; the past; the future. There are many artists in the group, as well as people from other professions, and above all researchers who strive to find out what Albanians’ *desire* to leave and forget looks like. The synonyms we have heard wearily merge with what comes to mind. *“Their path towards Europe is no longer a romance. Now the new slogan is ‘the path to normality’, writes Svetlana Boym, in “The Future of Nostalgia”, a book that somehow portrays our turmoil.*

But how do those remaining face loneliness, someone from the group asks. The Belgian-Albanian photographer girl reacts instinctively. She wants to say something. But it seems that the language, age or even her rather early maturity prevents her from doing so. She belongs to the generation that ran away from our aggressive tragic character after 1997. I remember a friend from Sarajevo, who once sadly recounted her own European journey. *“They only ask me about the massacres. Even when I want to get away and ask them to leave me alone, they only keep reminding me. They assume that we are only connected to the tragic aspect”.* This must be a feeling shared by the silent girl in the group. Indeed, we are tragic not as a fact and situation, but from what the times always have in store for us. Destiny? Who knows! A few months earlier, the iron chancellor, Merkel satisfied her Europeans’ curiosity about emigrants and the incessant desire of the so-called Third World (*now euphemistically known as Developing Countries*) headed in crowds towards Germany, with an apparently easy solution: *“Wir schaffen das!”* (We can do it!). *“What the heck are you saying, you whore, you crazy bitch,*



*räter*” (epiteti i erës naziste për “*tradhtare e popullit*”), iu përveshën ekstremistët e djathtë. Të kundogjendur tashmë. Kudo. Edhe tek ne, në Ballkan. Ky sens dhe përplasja e mendimeve të këtij grupi jep shpresë ta bëjë interesant për qasjen tonë.

Por për harresën ka dhe qasje të tjera. Umberto Eco ka argumentuar se të harrosh, veçanërisht kur do ta zbatosh në terren, të duhen strategji. Dikush harron “*jo thjesht me anulim, por me*

“*Volksverräter*” (“*traitor of the people*” a Nazi-era epithet), slammed the right-wing extremists . Ubiquitous now. Everywhere. Even here, in the Balkans. Such perception and clash of opinions of this group promises a more interesting approach.

But there are other approaches to oblivion. Umberto Eco has argued that to forget, especially if you want to do so in practice, you need strategies. Someone forgets “*not simply by cancellation, but*

*mbivendosje; jo nga mungesa, por duke shumëzuar prezencat*". Po prezencat tona janë të përziera dhe shumësia e tyre vjen instinktivisht nga reagimet tona. Shoferi nuk flet por e vendos qetë makinën në një udhë, duke lënë pas rrugën e re drejt Vlorës dhe kthehet befás në udhën e dikurshme, e cila s'ka ndryshuar fare. Nuk ka fare njerëz. Na duhet të pyesim. Por kë?...*A ka më lindje si dikur tek Ju?*-më pyet dikush. Falë një shkrimi të bërë ditët e fundit i sjell numrat sakaq. Shtesa ishte 600 mijë persona, në periudhën midis Censuseve para vitit 1989, teksa sot është apo jo më pak se 100 mijë! "*Hëm..*", ia bën djali, që drejton një teatër në një qytet të vogël në Gjermani. Është fare i paqëm edhe në përsiatjen e tij. I mjafton. A kanë qenë ndojëherë si ne këta?! Po. Në vitet 1750 Benjamin Franklin i përshkruante shumë gjermanë që vinin në Pensilvani në këtë formë: Kanë një "*çehre të qetë*". Më vjen të qesh me turqizim të theksuar, po nuk ia gjej dot fjalën në shqip. Kurse, gjermanët e kanë një kategori për atë që Franklin kish frikë nga: "*Überfremdung*" ose nga "*Mbivendosja*". Kjo ka të bëjë me frikën se shtëpia do të bëhet e panjohshme, sepse ka shumë të huaj në të, që flasin gjuhë të çuditshme dhe sillen në gjuhë të çuditshme. Por, djali i teatrit e kornizon me një matricë antropologjike, që i shkon asaj të prekjes reale dhe gjykimit para rastit konkret, me një "*çehre të qetë*". Janë orët e para të paradites dhe mendimet davariten, kur përpara nesh befás shfaqet:

## Narta

Është pak të thuash se Narta është e braktisur. Ajo, thjesht, ka ngrirë. Ka ende atë si biçim harkade prej hekuri shumë kilometra para qendrës, e cila të kujton se je në udhë të drejtë drejt saj, e shkruar në dygjuhë, pasi ky vend konsiderohet

*by superposition; not from absence, but by multiplying presences*". But our presences are mixed, and their plethora derives instinctively from our reactions. The driver does not talk, but quietly steers the car towards a road, leaving behind the new road to Vlorë and suddenly turns to the old road, which has remained unchanged. There are no people. We need to ask. But whom? ... *Is the number of births the same as it used to be?* – someone asks me. Thanks to a recent article, I provide the numbers right away. In between the censuses before 1989, there were an additional 600 000 persons, whereas today it is less than 100 000! "*Hmm..*", mutters the guy, who runs a theater in a small town in Germany. He is quite serene even while he contemplates. It is satisfying. Have they ever been like us?! Yes. In the 1750s, Benjamin Franklin used to describe the numerous Germans moving to Pennsylvania: They have a "*serene "çehre" (countenance)*". I laugh at my Turkism, but I cannot find the Albanian counterpart. In fact, the Germans have a category for what Franklin feared: "*Überfremdung*" or "*Foreign Influence*". It relates to the fear that the country will become unrecognisable due to many foreigners speaking strange languages and behaving in strange manners. However, the theatre guy frames it with an anthropological matrix, which matches the real touch and judgment of the concrete case, with a "*serene countenance*". It is the early morning hours and thoughts wander, when suddenly in front of us appears:

## Narta

It is an understatement to say that Narta is abandoned. It has simply frozen. That sort of iron arcade, written in two languages, as this place is considered a Greek-speaking minority, stands kilometers away from the center. This reminds you that you are

si minoritet linguistik grek. Në vetëm 10 kilometra larg qytetit të Vlorës, këtu nuk ka ritëm, as edhe një zhurmëz, nuk ka rini. Ata të paktit, janë mbledhur e qëndrojnë në sheshin e fshatit, shpërndarë në tre klube përballë dhe të heshtura si në një gjendje lufte ende panisur të ndonjë filmi Western. Skenë surreale. Teprica e njerëzve të tjerë është në autobus. Presin shoferin, që i shikon ngeshëm teksa pi. Pak burra të tjerë bjer-raditës i përcjellin me sy. Indiferentë. Sot jetojnë aty tek 300 banorët nga dikur kur ky vend gjallonte prej 3000 e kusur frymëve. Një pjesë e madhe e shtëpive të Nartës, disa forma guri paralelepipedë me kubaturë të ulët, pa pretendime eksteriori, me kopshte të vegjël, janë pothuaj të ngjashëm dhe të japin ndjesinë e këndshme të fshatit. Të pambajtur. Ke përfytyrimin e një vendi të vërtetë xhuxhash. Interiori ta plotëson më së miri me tavanet e ulëta dhe orendimin e ngushtë. Mbase nga shtatet e njerëzve. Edhe shpezët shtëpiakë mezi duken dhe frikohen. I vetmi element tërheqës janë drynat e shumëllojtë para dyerve të shtëpive ngado. Drynat janë që prej atyre të kohës së komunizmit, që dallohen fodulle e kryeneçe prej ndryshkut dhe të tjerave më të reja që shkëlqejnë. I bashkon një fakt: janë barrierë e 90 % e ndërtesave të pabanuara. Ky, ka kaq. Ky aq...Djali që na i tregon është pak i habitshëm, pasi buzëqesh vend e pavend dhe gjërat më të pazakonta i thotë me një qetësi të çiltër çarmatosëse. E kemi gjetur rastësisht. Në fakt, na ka gjetur. Vajza e fotos mjedisohet mirë me Nartën sepse ka qëndruar dhe kohë më parë për një set. Hidhërimi i ravijëzohet në fytyrë, kur merr vesh se familja ku bujtë nuk është më dhe madje një grua e shtëpisë nuk jeton më. Nga Narta, qytetarët ikën që nga muajt e parë të '90. Të tjerët shkojnë e vijnë, më së shumti drejt Greqisë. Gjuha i ndihmon. Këtu flitet një nga dialektet e harruar të greqishtes, por që të rinjtë e kanë

on the right track. Only ten kilometers away from Vlorë, but there is no rhythm here, not even a sound, no youth. The few remaining ones have gathered at the village center, scattered in three bars opposite each-other, silent, as if war were about to break out similar to in a Western movie. A surreal scene. The rest of the people are still on the bus. They await the driver, who sluggishly looks at them as he drinks. A few other idle men stare at them. Indifferent. There are about 300 inhabitants now where more than 3000 souls once dwelled. Most of the houses in Narta, with some low volume parallelepiped shaped stones, without any exterior pomp, with small gardens, they are quite similar and reminiscent of a pleasant village feeling. Unkempt. The image of a village of dwarves comes to mind. The low ceiling interior with the narrow furniture better reflects that image. Perhaps due to the people's stature. Even the hens are barely noticed and afraid. The only attractive features are the assorted padlocks on the gates of houses everywhere. The padlocks dating from the communist period can be distinguished from the newer shiny ones by their haughtiness and stubbornness caused by rust. They have one thing in common: they lock 90 per cent of the empty houses. This has this much. This that much ... The boy showing us around is a little odd, as he smiles willy-nilly and expresses the most unusual things in a disarmingly candid and calm manner. We found him by chance. In fact, he found us. The photograph girl quickly familiarises with Narta. She stayed here once for a photo shoot. Sadness dominates her face when she learns that the family that hosted her is no longer there, and that one of the women is no longer alive. People have been leaving Narta since the first months of 1990. The rest come and go, mostly towards Greece. The language helps. Here, they speak a forgotten Greek dialect, which the youth has improved with the regular one. The creak of an ungreased door, a head appearing

përmirësuar me të renë. Ndonjë gërvimë dere e pavajosur prej vitesh, ndonjë kokë që shfaqet si rastësisht pas dritareve të vogla është i gjithë peizazhi rural, i cili hasim. Të gjithë të moshuarit e mbetur kanë histori të njëllojtë. Të gjithë fëmijët jashtë. Më së shumti në Greqi. Vinë përkohësisht dhe ikin. Po, ka dhe peshkatarë. Ata, që lamë tek kafetë. Më të shumtë janë kthyer për ndonjë dokument, pra për pak kohë, e do rikthehen. *“Janë të sistemuar jashtë, po çfarë mund të bëjnë këtu”*, më thotë dikush nga zyrtarët. Mundohemi, t’u tregojmë shokëve të grupit, sesi Narta nuk ka qenë kaq e heshtur sa sot, pasi dikur ishte nga vendet më të njohura për prodhimin e verës, ullirit apo peshkimin. Tani? Nami i dikurshëm është si shajni. Gjatë muajve të dimrit në fshat, në rrugicat e vogla të pambajtura, janë pak oxhaqet e shtëpizave të cilat të tregojnë se ka ende ndonjë frymë. Sfida? Nuk ka kush të kullosë bagëtinë, të punojë tokën, të vjelë ullinjët. Madje, edhe ky djali, që më duket pak si i rehatuar psikologjikisht edhe ky do të ikë. Çuditërisht nuk kanë frikë për jetën. Këtë braktisje. *“Nga kush të kem frikë”*, na thotë 71-vjeçarja Kasiane Xhanaj brenda kopshtit të vogël të një shtëpie të ulët. Na bën udhë drejt shtëpisë: *“Ma ka bërë zoti gjëmën. Kam burrin e sëmurë (burri ka një lloj paralize dhe rri pa folur), këtë djalin, që ju shoqëron...ja e shihni vetë (Djali vazhdon me buzagazin aspak fajtor të Shvejkut) dhe më duhet t’i mbaj të gjitha vetë”*. Aty pranë, e reja, bashkëshortja e djalit, është më e drejtpërdrejtë: *“Nuk është mirë, nuk e shikoni. S’e kuptuat?! Po nuk kam hallin e tij, kam hallin e fëmijës, që do kurim...Eh, ku erdha e u martova këtu. Më morën në qafë”*...Pyetjet e pakta kanë përgjigje standarde. Një nga ato plagët sociale, që amplifikohen në televizionet tona dhe kthehet në reality show është gati. Kjo grua e re mund të bëjë çdo gjë...Sfondi shoqëror: Kujdesi i pakët mjekësor, shërbime të vobekta sociale, lidhjet ende me mblesëri, jo ndihmë për buj-

occasionally behind the tiny windows is the rural landscape that we encounter. All the elders recount the same story. All the children are abroad. Mostly in Greece. They briefly come and go. Yes, there are fishermen. Those we saw at the coffeehouses. Most of them have come back for their papers only for a short time and will go back. *“They have settled abroad, what can they do here”*, one official tells me. We try to explain to our friends in the group how Narta did not used to be this silent, as it once was a renowned producer of wine, olives, and fishing. Now? Its former reputation is a ghost from the past. During the winter months in the small unkempt alleys of the village, there are but a few chimneys that bear testimony to a soul. The challenge? There is no one to tend to cattle, to work the land, to pick the olives. Even this guy who seems quite laid-back wants to leave. Strangely they are not afraid for their lives. This abandonment. *“Whom should I fear”*, says the 71-years-old, Kasiane Xhanaj, in the small garden of her small house. She leads us towards the house: *God has punished me. My husband is sick (the man is paralysed and cannot speak), this boy, who is accompanying you... well, you can see for yourself (the boy keeps his Švejk like innocent smile) and I have to do it all alone”*. Nearby, the young woman, the son’s wife, is more direct: *“It is not good, don’t you see. Didn’t you realise?! But I am not worried about him, I am worried about the child, who needs treatment ... Eh, why did I come and get married here. They ruined my life... The few questions have standard answers. It is one of those social wounds that resonates on our televisions ready to transform into a reality show. This young woman can do anything ... Social background: little medical care, poor social services, arranged marriages, no farming assistance, perhaps... Kasiane plays the role of husband and that of village chief. She does everything under this roof, with a garden that has not seen the hands of a man, so that she can keep*

qësinë, mbase... Kasiane bën punën e burrit dhe të shefit fisnor. Bën gjithçka që nën këtë kulm, me një bahçe pa një dorë të mirë mashkulli, vetëm që gjërat të ecin. “Bëj atë që bëj çdo ditë, ndaj më duket se dita është njësoj, më thotë dikur”. Po...? “Ah..kur të mos jem! Ai, lart”-ma bën me shenjë me gishtin sipër. “Po erdhët sërish, këtu më gjeni...”, më thotë me pak ironinë e të moshuarit. Po ti?-, i them të resë. “Nuk e di. Po këtu nuk shtyhet...Të...”. I shoqi vazhdon buzëqesh. 20 minuta më vonë më shoqëron drejt një shtëpie tjetër, por atje, 77 vjeçari Vasil Shteto e ka marrë shtruar. Shtëpia ka një hyrje të ngushtë dhe një interior të mrekullueshëm për objektivat e fotografëve që e kërkojnë të veçantën në këto biçim rrëmuja të qeta me *Natura Morta* reale. Këtu e veçanta është e shprehur me detajet që janë kuturu. Burri kujdeset vetë për gjithçka, ndërsa shtëpia i ngjan një kantine të vockël lokale. Një palë syze që duket se kanë numër superior ia bën edhe më të vështirë komunikimin, por aspak ndjesinë. E habitshme se plakun nuk e shqetëson fare behja jonë tek dera. Fëmijët i ka jashtë. Qëndron i vetëm. Nuk e ka të shoqen. Na fton. “Po çtë bëj atje, kush do kujdeset për gjërat këtu. Bëj këtë, pastaj blej ndojë gjë, ja dhe këtë. (Heq një fuçi) Ja bëj raki, kujdesem për bahçen...E ç’më duhen njerëzit”. Ka qenë teknik diku dhe ishte tejet i kënaqur me punën e vet derisa një ditë i erdhi koha e pensionit dhe iu hap kjo pjesë jete, të cilës i është nënshtruar plotësisht. Si është dita jote? “Dita ime është si të gjitha ditët..., madje as nuk më duhet fare”, thotë dhe vazhdon e punon sikur ne të mos jemi. Po fëmijët? “Të martuar. Më mirë që janë në Greqi. Janë me veten, bëjnë punët e tyre. Këtu ka vdekur dhe ende nuk po e kallin...”. Sakaq ndalon. Çohet dhe na gostit shumë paqësisht me raki shtëpie. Si ndiheni në Greqi? “Atje si të huaj, kurse këtu po si të huaj”, më pret plaku, që nuk ia shoh dot vështrimin e lëbyrur pas syzeve të mëdha. Ka të drejtë patjetër, Dubravka Ugresić. “Problemi im është i

everything going. “I do the same thing every day, that is why the day seems the same, tells me once”. Yes...? “Ah.. when I shall be no more! He, above”-she points upwards. “If you come back, you’ll find me here...” she states characterised by the irony of the elderly. What about you?, I ask the young woman. “I don’t know. But it is unbearable here...To...”. Her husband keeps smiling. Twenty minutes later, he accompanies me to another house, but there, the 77-years-old, Vasil Shteto is quite relaxed. The house features a narrow entrance and an interior incredible to the photographers’ lenses that look for uniqueness in this sort of still clutter with real *still life*. Here, uniqueness is expressed with random details. The man takes care of everything by himself, whereas the house looks like a small local canteen. A pair of large glasses impede communication, but not the feeling. Surprisingly, the old man is not bothered by our sudden visit. His children live abroad. He is alone. He has no wife. He invites us in. “What am I supposed to do there, who is going to take care of things here. I am making this, and then I buy something, here, this too. (Removes a barrel) I am making raki, I take care of the garden... I don’t need anyone”. He used to be a technician somewhere and was quite content with his job until one day he had to retire and began this new chapter of acquiescent life. How is your day? “My day is like every other day..., I don’t even need it”, he says and continues his work as if we weren’t there. What about the children? “Married. They are better in Greece. They are by themselves; they go about their own business. Here everything is dead and haven’t yet set it on fire...”. He pauses. He stands up and very quietly treats us with homemade *raki*. How do you feel in Greece? “A foreigner there, and a foreigner here”, retorts the old man, whose look, obstructed by his large glasses, I cannot see. She is right, Dubravka Ugresic. “My problem is of a different nature”, writes Ugresic in one of her essays.

*një natyre të ndryshme”, shkruan në një nga esetë e saj Ugresiç. “Problemi im konsiston në faktin se unë nuk jam dhe nuk dëshiroj të jem ndryshe. Dallimi dhe identiteti im përcaktohen në lidhje me dinjitetin nga të tjerët. Me ata në shtëpi dhe atje jashtë, ku rrimë”.*

## Dukat

Dy orë më vonë jemi në Dukat. Në kohën e Evlia Çelebisë në shekullin e XVII Dukati kishte *“brenda vetes së tij 100 fshatra”*. Çelebia e tepron disi, por nuk gabon kur i përshkruan dukatasit si njerëz shumë të veçantë, me një trimëri të rrallë e që nuk e njihnin tërheqjen. Tashmë ka shtëpi por fare pak njerëz. Mezo Beqo, 80 vjeçare, si zor ta ketë dëgjuar Çelebiun, por jeton shumë larg, atje ku edhe vetë fshatarët hezitojnë të shkojnë. Duhet të ecim përmes përroit të fshatit të lemë një rrugë dhe të ngjitemi nga e djathta, ku kjo grua vitale na sodit me pëllëmbën e dorës mbi sy. *“Po çkeni o bij deri ktu. Keni humbur gjënë”*. (Qesh) A të vimë pak? *“Hajdeni kur të doni dhe rrini sa të doni. Muhabet dua unë”*, na thotë plaka hokatarë me rrobat tradicionale dhe zezonën e përgjithshme që e mbath ngado. Nuk ke frikë nga hajdutët? *“Ata më hanë munë. Po ç’ti vjedhësh plakës”*, thotë e fillon të pozojë. *“Po edhe ata i kam pasur, zemëro”* Edhe ajo e ka gjindjen e larguar, ndërsa është pjesë e identitetit të këtij vendi, ku na përzier një histori të ngatërruar të së shoqit, njerëzve, një histori që ngërthen ngjarje dhe histori dhe gjithnjë braktisje. *“Më thonë të iki, po ku të shkoj plak derëzeza. Jam mirë këtu. Më ka parë perëndia “*, thotë dhe qesh kot. *“Vinë e më shohin, po nuk më gjen dreqi këtu. Punoj mbaj veten, sa t’kem duar e këmbë. Kërcu mbi tokë, me një këmbë andej”*. Një shtëpi e madhe e ujdisur mirë, që ia kanë bërë njerëzit e afërt e bën të ndihet edhe e plotfuqishme. *“I kam që*

*“My problem revolves around the fact that I am not and do not want to be any different. My difference and identity are determined by the dignity of others. With those at home and those abroad, where we stay”.*

## Dukat

Two hours later we are in Dukat. During the time of Evliya Çelebi in the 17<sup>th</sup> century, Dukat incorporated *“100 villages”*. Çelebi clearly exaggerates, but he is not wrong when describing the Dukati people as special, of rare braveness who would not retreat. There are houses but very few people. Mezo Beqo, 80-years-old, would scarcely have heard about Çelebi, but she lives extremely far, where even the villagers hesitate to go. We need to walk through the village creek, leave the road behind us and climb to the right, from where this lively woman stares at us as with her hand over her eyes. *“What brought you up here sons? Have you lost anything?”* (Laughs) Can we stop by? *“You may stop by whenever and stay as long as you want. I’d love to chat”*, says the old funny woman with her traditional clothing and the overall misery that she wears everywhere. Aren’t you afraid of thieves? *“They can kiss my ass! What are they going to steal from an old woman”* says she while posing? *“Well, they have already been here, darling”*. Her family also left, whereas she is part of this place’s identity, where she provides a complicated story of her husband, the people, a history that includes events and accounts and always abandonment. *“They tell me to leave, but where to, wretched me. I am fine here. Thank God for small favours”* she says while laughing pointlessly. *“They come and see me, but nothing bad is going to happen to me here. I work, take care of myself, so long as I have my arms and legs. All by myself, with one foot in the grave”*. A big well-arranged house built





*mos i paça, po për kë ti kem, sa të vi dhe damllaja dhe të më marrë. Do jem më mirë andej*". Dhe, ia këput një të qeshuri. Është pika e fundit e këtij udhëtimi ditor, ndërsa klima e mrekullueshme dhe fshati i shpërhapur prehen, ashtu t'ngjitur një shpati mali dhe kapur aty-këtu me shtëpi lloj-lloj, pak para ngjitjes drejt Qafës së Llogorait. Eqerem Çabej të gjitha vendbanimet që kanë në emrin e tyre prapashtesën "at" i etiketonte me rrënjë qartazi, Ilire!! Ky është fillimi i muhabetit me pak të mbeturit te një pemë në mes të fshatit, ku gjithnjë mblidhen burrat e fshatit. Tashmë, ka pak syresh. Më i disponueshmi prej tyre Sinan Moraçi, 65 vjeç mundohet të hedhë dritë për pak gjëra. Është i rregulluar bashkë me të shoqen. Ka një shtëpi të këndshme ndërsa mbi të gjitha është i kënaqur me fatin e tij dhe punën. Fshatarët firojnë e firojnë. Ka ndërtuar vetë shtëpinë që e shikon sikur po e këqyr për herë të parë. Ka fëmijë që i respekton dhe e duan dhe një grua zonjë që duket nga shtëpia, por...që tashmë kanë mbetur vetëm. "Sa rriten fëmijët këtu vetëm duan të ikin. Të ikin e turren nga të munden. Po ku drejtin duan të ikin vallë?!" Më tregon me detaje nga ikin të rinjtë dhe si është braktisja. "Braktisjen nuk e ndjen, por në darkë, kur mblidhem me time shoqe...O zot, sa vetëm jemi". Por fshati ka ende një shkollë dhe fëmijë që ende vinë nga diku. Nuk të kënaq? Jo, ia bën me kokë. Ka të drejtë. Janë aq të pakët saqë i mban dhe një minibuz që na gjen kur largohemi. Si zakonisht fëmijët sa zbresin shpërhapen ngado duke lëshuar pasthirrma gëzimi prej çlirimimi. "Sa të mbaroj shkollën, do të iki". Ku? "Do të iki te vëllai", më thotë dikush. Ku është vëllai? "Është jashtë. Në Itali. Dua të iki në Angli". Po kush do të mbetet këtu?-më shpëton befas. "Ne, pleqtë. Do të na varrosin, të huajt", më ka thënë plaka, por në fakt para vetes kam djalin që më shikon ngultas dhe nuk i bën përshtypje pyetja ime...e pavend. "A të iki, se dua të mësoj", më thotë çapkën. Ikim nga ikja.

by her family makes her feel strong. "I own these, but I wished I had nothing. I am all alone awaiting death. I'll be better there". And bursts into laughter. It is the last point of this daily trip, while the wonderful climate and scattered village rests, fixed to the slope of the mountain with sporadic houses of all kinds, at the foot of Llogora Pass. Eqerem Çabej clearly identified all settlements ending with the suffix "at"!! as Illyrian. This is the beginning of the conversation with the few remaining by a tree in the center of the village, the gathering point of the men of the village. There are few of them nowadays. The most willing one, Sinan Moraçi, 65-years-old, attempts to shed light on a few matters. He has settled with his wife. Has a nice house and above all he is content with his fate and work. The villagers keep fleeing. He built the house himself and gazes at it as if it were the first time. He has loving and respected children and a great wife, who can be seen from the house ... however, they are alone now. "As soon as the children grow up, they just want to leave. They flee wherever they can. Where the heck do they want to go?!" He explains where the youth goes and what abandonment feels like. "You don't feel the abandonment, but in the evening, when I sit with my wife...Oh God, how alone we are". But the village does still have a school and children that come from somewhere. Is that not enough? He shakes his head. He is right. They are so few that a minibus suffices to transport them. As we are about to leave, we see the children getting off and happily yelling and freely running around. "As soon as I finish school, I am leaving". Where? "To my brother", says someone. Where is your brother? "He's abroad. In Italy. I want to go to England". But who will remain here? -I instinctively ask. "Us, the elderly. We'll be buried by foreigners", told me the old woman, but, in front of me stands the boy staring and not at all impressed by my ... misplaced question. "May I leave now, I want to study", tells me wittily. Let us get away from leaving.

## Intermexo

Censusi i vitit 2011 dha për herë të parë shenjat e trishtta se emigrimi ishte faktori më i rëndësishëm në humbjen e madhe të popullsisë prej 269 mijë personave në periudhën 2001-2011, teksa arriti deri në 8.8 përqind të popullsisë së vitit 2001. Megjithë kontrollin e të dhënave e vlerësimeve direkte të INSTAT-it, në këtë periudhe ishin rreth 482 mijë shqiptarë që u larguan nga vendi, një numër që gjithsesi asokohe u mendua se do kompensohej pjesërisht nga imigracioni dhe rritja natyrore. Por pak më vonë, një studim i Qendrës për Kërkime Sociale dhe Ekonomike për potencialet e emigrimit tregoi për një tendencë të lartë ikjes nga vendi të familjeve, këtë herë edhe me të ardhura më të larta. Anketimi i vitit 2018 gjeti se edhe rreth 55% familjeve që kishin të ardhura ndërmjet 1000-1400 eurove, donin të iknin. Madje, kjo nuk mbaronte këtu, pasi në këto përmasa, planifikonin të iknin edhe personat me paga 470 deri në 950 euro në muaj. Por nëse do të kishte të dhëna edhe më të kujdesshme, do të shikohej edhe probleme me fashat e tjera të shoqërisë shqiptare, kurse fasha e popullsisë me paga nën 370 euro, pothuaj mbi gjysma e tyre planifikonin të iknin.

## Rubiku


Mëngjesi i ditës tjetër na gjen në një aks tjetër, por këtë herë kah veriu. Larg kryeqytetit, por që falë “Rrugës së Kombit” na ka ardhur shumë afër. Rubiku ka të gjitha ndjesitë e një Ghost city. Pasi kalon Urën e Milotit, të mirëpret lugina e bukur të Fanit, ku sytë instinktivisht të mbesin nga Kisha e të Shëlbuemit, vendosur mbi kepin e bardhë të Rubikut, objekt i shekullit XIII dhe një nga më të rëndësishmet e trashëgimisë së kulturës kombëtare. Abacia e Benediktinëve të Rubikut. Pastaj

## Intermezzo

For the first time, the 2011 census confirmed the sad signs of emigration as being the most important factor in the large population loss. It amounted to 269 thousand persons for the 2001 to 2011 period, as it reached up to 8.8 per cent of the 2001 population. Despite the data control and direct evaluations by INSTAT, 482 thousand Albanians left the country at this period, a number which was believed to be compensated in part by immigration and natural population growth. However, later, a study of the Social and Economic Research Center on the potential of emigration, identified an increasing trend of families, even higher income ones, that were leaving the country. A 2018 survey found out that about 55 per cent of families with monthly incomes ranging between 1000 to 1400 Euro wanted to leave. In fact, the same percentage even applied to individuals with salaries ranging from 470 to 950 Euro per month. And if there were even more detailed data, problems with other social strata would be noted, whereas over half of the population strata with under 370 Euro monthly salaries were planning to leave.

## Rubik

The next morning finds us on another route, this time headed North. Far from the capital, but which, thanks to the “Nation’s Highway” has brought us closer. Rubik truly feels like a ghost city. After passing the Milot Bridge, the beautiful valley of Fan welcomes you, where eyes instinctively focus on the Church of Redemption, standing on the white rock of Rubik. It dates to the 13<sup>th</sup> century church, which is one of the most important national cultural heritage monuments. The Benedictine Abbey of



françeskanët. Zhguni i zi i frikshëm u zëvendësua nga zhguni i murrmë, kujtoj një metaforë lokale. Këto shkëmbejmë me miqtë e huaj, teksa duket uzina në të djathtë e shkatërruar dhe skeleti i saj i frikshëm në degradim. Fat të keq ka pasur qyteti për shumë vite, por sidomos në kohëra të vjetra ku ndryshku i kuq shfaroste njerëzit, mbyste bagëtitë dhe dëmtonte të mbjellat. Legjendat lokale ia atribuojnë hyjneshës Robiko, shpëtimin e banorëve nga kjo murtajë e kuqe. Ishin minatorët e sjellë nga një firmë italiane në vitet '30-të

Rubik. Later, Franciscan. The dreaded black cloak was replaced by the brown one, a local metaphor comes to mind. This is what we share with our foreign guests, as the ruined factory appears on the right and its scary deteriorating skeleton. For many years, the town has experienced bad luck; especially in older times when the red rust wiped out people, slaughtered animals and destroyed crops. Local legends attribute the protection of the people from this red plague to goddess Robigo. Miners from an Italian firm in the 1930s were the first to work in the

që nisën të parët punimet në minierën e bakrit. Më pas, socializmi ndërtoi Uzinën e Përpunimit të Bakrit, një krenari e Industrisë së Rëndë, madje njëra ndër katër më të zgjedhurat në Evropë. Këtu thuhej se dilte edhe ar, që kur ia tregoj grupit më shikojnë të habitur para kësaj gërmadhe hekurishtesh edhe pse oxhakët ende lartohen. *“Erdhën pastaj njerëzit, panë se atje ishte një vend i bukur banimi, dhe themeluen mbi shkrep shtëpinë e vet të thjeshtë”*, shkruante Barcata te “Lulet”.

Bashkë me grupin mendojmë të bëjmë një zgjidhje tjetër për t’iu afruar njerëzve dhe i drejtohemi pushtetit lokal, që kur i shpjegojmë qëllimin, na vihen mirësisht në ndihmë. Piketojmë disa familje dhe një djalë i njësisë bashkiake në bën udhë drejt Mark Zef Përgjokës. Ai ka dalë në pension dhe nga një shtëpi e largët sipër qytetit bën jetën e tij të pensionistit. Ka qenë dikur në uzinë ndërsa fëmijët i janë larguar. Bashkë me të shoqen ngrysin jetën në një shtëpi të ulët, ngritur me mundin e dekadave punë, për të cilat ai është dekoruar edhe me një certifikatë paaftësie. I janë dorëzuar përditmërisë: *“Të jenë fëmijët mirë, po për ne gjërat mirë do jenë”*, na thonë sapo ulemi para shtëpisë. Kanë një problem pensioni që ndoshta mund të ishte pak më ndryshe, sepse edhe i shoqi nuk kishte kaluar mirë me shëndet, por mjafton dhe kaq. Nuk ankohen. I janë dorëzuar fatit: *“Zoti na ka parë dhe me kaq sa na ka dhënë”*, u flet përkorja. E shoqja, që duket se menaxhon, na e tregon më lehtë situatën, por aspak dorëzimin. *“Kur vjen pensioni, nuk ke kohë për gjëra të tjera. Ky ishte fati ynë. Po sesi të vjen të rrisësh fëmijë dhe të vijë puna e të mos i kesh më afër...”*. Burri e dëgjon. *“Askush nuk do rrijë më. Lajmi i ditës është kur merr udhë të iki. Dje, ikën dhe...Eh, është një listë njerëzish që nuk i njohim, por që mjafton”*. Pak shtëpi më tutje, qëndron e vetmuar nëna e disa fëmijëve. Tereza, 72 vjeç, i ka të gjithë fëmijët jashtë dhe tashmë menaxhon e vetme një jetë, që për të është e mjaftë.

copper mine. Later, socialism built the Copper Processing Factory, the pride of Heavy Industry, in fact one of the four most renowned in Europe. It is said that gold was also mined, and when I tell this to the group, they look baffled in front of this ruin of scrap iron, even though the smokestacks are still standing high. *“Then came the people, they saw a beautiful dwelling place and built their modest homes upon the cliff”*, recounted Barcata in “Lulet” (Flowers).

All together, we decide to approach the people in a differentiated way, thus we head to the local government, and upon explaining our purpose, they kindly come to our aid. We pinpoint certain families and one guy from the municipality unit leads us to Mark Zef Përgjoka. He is retired and gets on with his life from his far house, overlooking the town. He used to work in the factory, whereas his children have moved away. Together with his wife, they spend the rest of their life in a small house, built with the sweat of decades of work, for which he has even been awarded a disability certificate. They have acquiesced to their routine: *“As long as the children are alright, it is fine with us”*, he tells us as we sit in front of the house. They have a pension problem, which could have been different as the husband had a health problem, but that sufficed as well. They do not complain. They have succumbed to their fate: *“God has blessed us with what we have got”*, he speaks with restraint. The wife, who seems to get by, speaks with neutral notes of the situation, unlike the acquiescence. *“When you retire, you do not have time for anything else. Such was our fate. But it is a strange feeling to raise your children and then one day they are gone...”*. The husband listens. *“No one wants to stay anymore. The news of the day is who is leaving. Yesterday, they left and ... Eh, it is a list of people we do not know, but that’s enough”*. A few houses down, the mother of several children lives alone. Tereza, 72-years-old; all her children live abroad and now she leads a solitary life, which

Ka qenë edhe vetë jashtë. Në Itali, kur shkon, e kënaq shumë mjedisi dhe qetësia. Ka dhe njerëz të qëndrojnë, veç fëmijët që e gëzojnë, por shtëpia është këtu ku ndodhet. Fëmijët e kthejnë sërish pas me premtimin ta marrin. *“Asgjë nuk krahasohet me vendin tënd”*. Për fat atë ditë gjejmë disa prej fëmijëve, ardhur prej jashtë, mbledhur t’i bëjnë shoqëri të ëmës për një ditëlindje. Askush nuk ka vitalitetin e saj, por duken qartazi si bjerraditës. E qesëndisin disi e bëjnë hoka. Por, në fund, të gjithë ankohen sipas mënyrës së tyre. *“Çfarë mund të bësh këtu? Këtu nuk ka punë për askënd. Pse jetohet këtu?”* Fëmijët, që në fakt janë të rinj, i rrotullohen plakës dhe duket se i janë dorëzuar mendimit se vetëm këtu nuk jetohet. Por, nuk lenë pa sharë çdo gjë andej dhe të tallen me vendet ku janë. Njëra prej vajzave ka tatuazhe. E konsideron veten evropiane perëndimore. Evropa është më shumë se objektiv për të ikur që këtu. *“Evropianët Qendrorë dhe Lindorë duket se kanë humbur disa nga ëndrrat e tyre; në vend që t’i projektojnë fantazitë e tyre romantike në Perëndim, ato kthehen në introspeksion, as ta duan Perëndimin pa kushte dhe as ta fajësojnë atë për sëmundjet lokale. Në dritën e nacionalizmit postkomunist, ideja e Evropës përvetëson një atmosferë më pragmatike. Nuk është çështje romancash, por thjesht domosdoshmëri”*, shkruan Svetlana Boym, tek *“The Future of Nostalgia”*. *“Po pse nuk e merrni nënën”*. Fëmijët shikojnë njëri-tjetrin. *“Nuk shkoj, ma pret plaka me veshjen tradicionale, e mbledh buzët, që shpërndajnë ca rrudha në formë rrezesh ngado. Na ruan Zoti, mu këtu ku jemi. E pastaj, çka me ba?! Hajd, mo e gjithë bota asht nji”*. *“Këtu asht ari, po ku don me dijt këta”*, më thotë plaka. Teksa grupi shkrihet me familjarët dhe kalojmë në një bisedë të lirë, kujtoj se dikur, Rubiku kishte vërtetë minierë nxjerrëse, një uzinë përpunuese të bakrit dhe 4 orë e më shumë udhë nga Tirana. Ja këtu në këtë vend, ku të rinjtë që duan të ikin nuk u bën asnjë përshtypje.

she finds adequate. She was also abroad. When she visits Italy, she enjoys the environment and the quietness. She can stay and enjoy her children, but her home is here. Her children bring her here with the promise to take her back. *“Nothing compares to your country”*. Luckily, that day we meet some of her children, who have come to keep her company on a birthday occasion. None of them shares her vivacity, they all clearly seem like loafers. They like to tease and make jokes. But, in the end, they all complain in their own way. *“What can you do here? There are no jobs. Why live here?”* The children, who are young, surround the old woman and seem to have succumbed to the idea that one cannot live here. However, they complain about everything over there and deride the countries where they reside. One of the girls has tattoos. She considers herself a Western European. Europe is more than a goal to leave this place. *“Central and Eastern Europeans seem to have lost some of their dreams; instead of projecting their romantic fantasies to the West, they turn them into introspections, neither loving the West unconditionally nor blaming it for their local problems. Considering post-communist nationalism, the idea of Europe embodies a more pragmatic atmosphere. It is not a matter of romances, but simply of necessity”*, writes Svetlana Boym, in *“The Future of Nostalgia”*. *“Why don’t you take your mother with you”*. Her children look at each other. *“I’m not going, retorts the old woman in her traditional clothing, pursing her lips and the wrinkles take the form of rays. God protects us, right here. So, what can we do?! C’mon, the whole world is one”*. *“The gold is right here, but they don’t care”*, states the old woman. As the group blends with the family members and we hold other conversations, I remember that once, indeed, Rubik had extracting mines, a copper processing factory and was more than four hours away from Tirana. Right here, in this place, where the youth wants to leave and could not care less.

## Rrësheni

Rubiku na merr shumë kohë, por jo aq sa të mos mbërrimë në kohë në mbrëmje në Rrëshen. Nga ky vend, ku dikur gjallonin dhe bënin jetë 53 mijë banorë deri në vitin 1990-të, sot qyteti është rrudhur në afro 30 mijë, pra, 23 mijë banorë janë zhdukur. E re, relativisht, historia e Rrëshenit. U krijua më 15 prill 1949, si qendër e rrethit të Mirditës, e cila, deri në atë kohë, kishte qenë në Shpal, si Nënprefekturë. Më parë, Rrësheni ishte thjesht një nga fshatrat më të mëdhenj të zonës së Kthellës, një si qendër zejtare, ku 3-4 dyqane që administroheshin nga vendësit shkëmbejnë mallrat në bashkëpunim me tregtarë shkodranë e krutanë. Sot, shifrat janë të dhimbshme: 3050 familje në trevën e Mirditës jetojnë vetëm me të ardhurat e përkrahjes sociale. Dhe, sërish nuk mbaron këtu. Qindra prej familjeve mirditore e depozitojnë normalisht emrin në listat e gjata të borxheve në dyqanet e miellit dhe të bukës. Dhe, shifrat “premtuese” nuk mbarojnë këtu, pasi 50% e popullsisë së qytetit të Rrëshenit, qendra administrative e rrethit, kërkon punë dhe është regjistruar pranë zyrës së punësimit si punëkërkues. Paçka se këtu dikur kishte një strukturë industriale, ku kërkoheshin vazhdimisht njerëz për punë. Në socializëm edhe këtu kishte një fabrikë pasurimi me emër. Shqip-tarët, të ashtuquajturën “Toka e Katedraleve”, e njihnin për një shpirt shumë të pavarur, që i solli problem me të gjitha regjimet. Vlash Dode Kaçorri, 70 vjeç, ka qenë në një nga këto ndërmarrje dhe tashti është i vetëm në shtëpi. E ka lënë e shoqja sepse vdekja e ka thirrur ndërsa e bën jetën i vetëm në një pallat të kohës së komunizmit, ku koha kalon me televizorin dhe pastaj me bashkëmoshataret, ku thurin dhe shturin lajmet dhe ankohen për gazetarët. Në një shtëpi të

## Rrëshen

We spend a lot of time in Rubik, but that does not stop us from arriving in time for the evening in Rrëshen. Fifty three thousand inhabitants once lived and resided here up until 1990; today the town has shrunk to about 30 thousand, thus, 23 thousand inhabitants have disappeared. Relatively, recent, the story of Rrëshen. It was established on 15 April 1949, as the center of Mirdita district, which up to that point had been in Shpal, a sub prefecture. Previously, Rrëshen was simply one of the largest villages of the Kthella area, sort of a craftsman center, where 3-4 locally run stores would exchange goods in cooperation with merchants from Shkodra and Kruja. Now, the figures are painful: 3050 families in the Mirdita region survive only on social assistance. And it does not end here. Hundreds of Mirdita families write down their names on the lengthy debt lists in flour and bread stores. The “promising” numbers do not end here, as 50 per cent of the population of Rrëshen, the region’s administrative center, seeks employment and has registered as jobseeker at the employment office. Even though, here, an industrial facility once stood, which was always employing people. During socialism, a renowned enrichment factory was based here. Albanians regarded the so-called “Land of Cathedrals” as quite an independent soul, which caused trouble for all types of regimes. Vlash Dodë Kaçorri, 70-years-old, used to work in one of these state enterprises and now is alone at home. His wife has passed away, whereas he leads a solitary life in an old communist-period apartment, where he passes his time with television and with his friends, who twist and untwist the news and complain about journalists. Standing in his modest house, the old man wants to tell stories, but is interrupted by the foreigner’s “naive” questions. “How do you live





përkorë plaku do të rrëfejë shumë, por stopohet nga pyetjet “naive” të huajve. “Po si jeton këtu?” “Jam i kënaqur. Pres vetëm atë që presim të gjithë. Të ritë janë larguar dhe janë rregulluar”, u thotë me gjuhën e tërthortë. “Pse keq është këtu?!” Qyteti rrudhet përditë dhe të gjithë priten sa të marrin pak krahë dhe të ikin. “S’e kuptoj. Të gjithë duan të ikin nga ky vend, u thotë duke hedhur sytë nga dritarja. Dikur vinin ngado të jetonin këtu, tani ikin me kuç e me maç. Edhe, këta, -bën me kokë nga dera nga ku dëgjohen disa gjëra, -flasin vetëm të ikin. Po ku ikin vallë?!”

Përballë banon Marie Gjete Margjini. 70 vjeçarja ka një djalë me aftësi të kufizuara dhe rampa e shkallëve është përshtatur për karrocën e tij. Një grua me fytyrë ikonike mirditoreje dhe një përkorje fetare përgjigjet thjesht me rrokje. Ka një vështrim të hidhëruar, por nuk ankohet. I biri, që e hasim me karrocën e tij, ka fëmijë dhe vajza e bukur e tij bën detyrat ngjitur me shtratin e përshtatur së të atit me paaftësi. I shërben të gjithëve. Fëmijët e tjerë janë të ndarë, kurse një nga fëmijët e gruas jashtë plotëson paratë e familjes. Sfida më e madhe është për të bërë paratë e ilaçeve dhe të sajohet vakti i ngrënies. Mbijetesa dhe qëndrueshmëria e fisit është mbi të gjitha. E moshuara ka punuar në një furrë buke dhe për këtë është bash e kënaqur, paçka lodhjes, por nga fytyra e saj buzëqeshja duket se ka kohë që është arratisur. Tregon thjesht dhe vuajtja më e madhe tregohet si një përditmëri. I gjithë grupi është i heshtur. Vuajtja dhe dinjiteti i saj të heshtin. Këtu ke përgjigje për ikjen. Përballjen e varfërisë. Kohën. Fotot e vajzës që do ti shoh më vonë tregojnë shumë më tepër sesa përshtatimi im i varfër. Qëndrimi i drejtë dinjitoz i nënës dhe mbesës dhe përballja me jetën është kjo që është. Ikim. Nuk do kthehem më. Kurrë.

here?” “I’m content. I’m waiting for the same thing as everyone else. The youth has moved away and has settled”, he says in a roundabout way. “Is it terrible here?!” The town shrinks daily, and all wait until they get the courage to leave. “I don’t understand. Everyone wants to leave this place”, he says as he stares from the window. Once they came from all corners to live here, now they flee taking everything with them. Even them, - moves his head towards the door where some voices can be heard, - speak only of leaving. But where are they going?!”

Marie Gjete Margjini lives opposite. The 70-year-old has a disabled son, and the stair ramp has been adapted for his wheelchair. A woman with an iconic Mirdita woman’s face and of a religious sobriety answers simply with syllables. She has a grieving look but does not complain. Her son, in the wheelchair, has children and his beautiful daughter does the homework next to the adjusted bed of her disabled father. She takes care of everyone. The other children live separately, whereas one of the woman’s children living abroad helps financially. The greatest challenge is to secure the money for medication and to provide a meal. The survival and stability of the tribe is most important. The old woman used to work at a bakery, and she is pleased about that, despite the fatigue. However, the smile has long vanished from her face. She speaks in a simple manner and the greatest suffering is described as part of the everyday. The entire group is silent. Her suffering and dignity silence us. Here is the answer to leaving. Facing poverty. Time. The girl’s photographs, which I am going to see later tell much more than my brief description. The dignified and proper attitude of the mother and her niece and the ordinary struggle with life. Let’s leave. We will not return. Never.

## Intermexo-emigrimi

Një valë të re emigrimi paralajmëronin pak muaj më parë të dhënat e Zyrës Evropiane të Mbështetjes së Azilantëve (EASO), teksa raportonin se rreth 12.000 shqiptarë kanë aplikuar për herë të parë për azil në një nga vendet e Bashkimit European, vetëm për periudhën janar-korrik 2019. Veç tyre, 2000 shqiptarë të tjerë kishin tentuar rishtazi për ta fituar këtë status. Për ta bërë më të hidhur të gjithën do shërbenin të dhënat e Institutit të Statistikave që shtonte se paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të parë 2019, ishte fiksuar te 51.531 lekë. E të mos harrojmë se s'ishte llogaritur ende pandemia dhe katrohura që vinte pas.

## Shiroka

Pak orë më pas, në mëngjesin e një dite të vrenjtur, drejtohemë drejt Shirokës. Shkodra, ku kemi kaluar natën na ka qetësuar disi. Djali i teatrit është mënjeluar në mbrëmje për të hedhur shënimet e para të braktisjes dhe harresës që po pllakos qendrat e vogla. “*Më duhet pak kohë!*”, na thotë. Shiroka është emri i një fshati, sot lagje e qytetit të Shkodrës, në bregun jug-perëndimor të Liqenit të Shkodrës. Thuhet se dikur kanë banuar paraardhësit e Shalës, Shoshit dhe të Mirditës, kurse Pjetër Budi në letrën e Tij të 15 shtatorit 1621 përmend se në bregun e Liqenit të Shkodrës është një qendër me emrin “Skirosi”, për të cilin Injac Zamputi, mendon se bëhet fjalë për Shirokën. Këto janë referencat historike, që i mbledh për t'i shpjeguar. Shiroka, sot, ka 308 familje. Po, vallë, a janë sërish aq? Qëndrimi ynë është në një shkollë. Është zgjidhje e këndshme dhe përpiqem me Klaudjan të rregullojmë lejen. Dikur ka qenë me e lehtë. Tashmë një numër rregullash e bën të vështirë kontaktin me fëmijët. Një shkollë tip-

## Intermezzo-emigration

A few months earlier, data from the European Asylum Support Office (EASO) warned of a new wave of emigration, as they reported that about 12 000 Albanians had applied to one of the EU countries for the first time, only for the 2019 January to July period. Two thousand additional Albanians had reapplied to obtain this status. The INSTAT data would make it even bitter, as they showed that the average gross monthly salary for a salaried employee, during the first 2019 quarter, was fixed at 51,531 ALL. And we should bear in mind that the pandemic and the chaos that ensued was not even considered.

## Shiroka

A few hours later, in the morning of a cloudy day, we head towards Shiroka. Shkodra, where we spent the night somehow calmed us. The theatre guy excused himself to jot down the first notes on abandonment and the oblivion that has afflicted small towns. “*I need some time!*”, he says. Shiroka is the name of a village, currently a neighbourhood of the city of Shkodra, on the southwestern shore of the Shkodra Lake. It is said that here once lived the predecessors of Shala, Shoshi and Mirdita. Whereas Pjetër Budi in his letter dated 15 September 1621 mentions that on the shore of the Shkodra Lake lies a center named “Skirosi”, which Injac Zamputi, believed to have referred to Shiroka. These are historic references, which I collect to explain to the group. Shiroka, today, has 308 families. Are there still that many perhaps? Our stop is at a school. It is a nice choice and together with Klaudia we try to secure permission. It used to be far easier once. There are now several rules that make contact with children difficult. A typical school, raised on a sort of shore,

ike, ngjitur në një si breg, ku shkallët gati 90° e vështirësojnë dhe më shumë ngjitjen. Duket si e futur mes një shtegu. Na duhet disi kohë për t'u marrë vesh për lejen, por befas vjen. Mësuesit e shkollave lokale nuk bëjnë të sofistikuarin. Interesante është se mësuesi që na ndih ka një bluzë me një mbishkrim gjermanisht. Kjo shërben për lidhjen më të afërt me gjermanët dhe e bën më të thjeshtë shpjegimin. *"Kam qenë jashtë në Gjermani por erdha. Po të kisha mundësi do të ikja sërish"*, i thotë miqve gjermanë, që thjesht e ndjekin duke tundur kokën dhe pastaj flasin shtruar. Disa fëmijë të këndshëm, që mundohen të çlirohen nga autoriteti bëhen miqtë tanë. Secili ka dikënd jashtë, e që shpejt do t'i bashkohet. Medoemos. Të mendosh nuk e kanë kaluar ende adoleshencën. *"Atje është mirë"*. Po pse? *"Secili ka punë. Secili ka një shtëpi dhe ke me çfarë me u marr"*. Po ju? Një nga miqtë gjermanë e ftojme e zë vend te podiumi i mësuesit dhe mundohet ti kuptojë dhe t'u shpjegojë, por nuk mund të futet shumë në hulli. U thotë disa gjëra të përgjithshme dhe vështirësitë e tyre, por më shumë dëgjon fëmijët. *"Këtu nuk ka vend për punë. Dhe, nuk ke me çfarë me loz. Në 6 t'pasedites, jemi të gjithë në shtëpi"*. *"Ka shumë dritë"*, i thotë dikush. Të rritur para kohe dhe nihilistë me çdo gjë në vend, madje edhe kur gjermanët e rinj shpjegojnë vendin e tyre. *"Aty është para- jsë. E kam parë vetë"*, vendos veton një vajzë *Po si?-e pyet. Vajza nuk di ta shpjegojë. Muhamed Kallmi, klasa e 6- 10 vjeç, Gesart Meti Klasa e 8-13 vjeç, Kledis Malli klasa e 8-13 vjeç, Qemal Armoku, klasa e 6- 10 vjeç, Arseld Sela, klasa e 6- 10 vjeç, Ebigela Plisi, klasa e 8 -13 vjeç, Rinelda Balani, klasa e 8-13 vjeç, Alesia Selimi, klasa e 8 -13 vjeç janë bashkë në një klasë dhe të qartë: Po mësojmë se do ikim! Në fakt thjesht se janë të moshave të ndryshme dhe një klasë e tregon hapur sesi po firojnë. Mësuesit janë aty. Të heshtur.*

where the 90° stairway makes climbing difficult. It appears to be stuck between a pathway. We need some time to get the permission, but surprisingly we get it. Local schoolteachers are not presumptuous. It is amusing that the teacher helping us has a t-shirt with German writing. This serves to break the ice with the Germans and makes it easier to talk. *"I left for Germany, but I came back. If I had the opportunity I would leave again"*, he said to the German guests, who simply followed shaking their heads and speaking calmly. Some sweet children, who are trying to escape authority become our friends. Each one of them has a relative abroad, and plan to joins them soon. Necessarily. And to think that they have not gone through adolescence yet. *"It's great over there"*. Why? *"Everyone has a job. Everyone has a house and there is a lot to do"*. What about you? We invite one of the German guests to the teacher podium, and he tries to understand and explain to them, but cannot find the right way. He speaks of difficulties, but mostly listens to the children. *"There are no jobs here. And there is nothing to play with. At 6 pm, we are at home"*. *"There is so much light"*, someone says. Grown up too soon and nihilists about everything in the country, even when the young Germans explain their own country. *"It is heaven there. I saw it"*, one of the girls rules out. *How?* -he asks. The girl cannot explain. Muhamed Kallmi, 6<sup>th</sup> grade-10 years-old, Gesart Meti 8<sup>th</sup> grade-13 years-old, Kledis Malli 8<sup>th</sup> grade -13 years-old, Qemal Armoku, 6<sup>th</sup> grade - 10 years-old, Arseld Sela, 6<sup>th</sup> grade - 10 years-old, Ebigela Plisi, 8<sup>th</sup> grade -13 years-old, Rinelda Balani, 8<sup>th</sup> grade -13 years-old, Alesia Selimi, 8<sup>th</sup> grade -13 years-old are in the same class and quite resolute: We learn because we are going to leave! The simple fact that they are different ages and in the same class, clearly shows how their numbers are dwindling. The teachers are there. Silent. They also want to join those who are

Edhe ata duan t'i bashkohen atyre që nuk janë më aty.

Amelisa Bankaj, klasa e 8-13 vjeç, një përzierje e bukurisë fëminore por edhe e qartësisë, mbetet peng i ngërçit të pyetjeve. "Nuk e di", përgjigjet. Problem mbetet krahasimi dhe cila quhet e mirë. "Jemi të trishtuar sepse për çdo vjet ka më pak nxënës. Ikin me familje dhe...të gjithë bisedat e tyre lidhen me ikjen", thotë një mësues. E trishtuar është kur ikin dhe mësuesit. "Sa të mbaroj klasën e nëntë, -thotë dikush- do të largohem direkt te vëllai". Dhe është i lumtur. Po prindërit? "Edhe ata do t'i marrim. Të gjithë", thotë njëra nga vajzat..."Unë kam qenë jashtë. Është bukur. Pastër. Shumë vend i madh Gjermania...Është qetë. Nuk kam frikë. Ka gjëra të mira dhe ka shumë rregull". Mungesa e drejtësisë është e futur thellë dhe tek këta fëmijë. U jap të drejtë. Po, vallë të jetë qetësia që nuk i mban?! Këtu, ku ata mësojnë dhe vërtetë janë në një shkollë bajagi të mirë, është vërtetë qetësi deridiku, madje nga ato syresh që paralajmërojnë se...shumë shpejt gjithçka mund të marrë fund. Kam frikë se edhe vetë mësuesit, që na shoqërojnë dhe janë të hapur për çdo gjë, presin një mundësi. Si do t'u vijë sikur të mbarojnë nxënësit?-pyes mësuesin e fiskulturës. "Po fëmijët realisht po mbarojnë. Ka gjithnjë e më pak dhe nuk është e largët dita kur do të jemi të vetëm", tund kokën. Po nuk ka politika? Cili duhet të mbajë gjallë këtë zjarr që po shuhet. Dikush duhet të mendojë! Po mendja më shkon dhe teksa kujtoj një akuzë që bëhet normal sot nga zyrtarë të vendeve tona por edhe konspiracionistët që kanë mbirë ngado: Gjermania po na i merr me zor njerëzit dhe më duket se në formë cinike, ka një të vërtetë të hidhur indirekte, kur ne veç e mallkojmë vendin tonë, kurse varfëria dhe skamja na kanë topitur deri aty ku nuk dimë se...ç'duam.

no longer there.

Amelisa Bankaj, 8<sup>th</sup> grade -13 years-old, a blend of childlike beauty as well as clarity, gets lost in the questions. "I do not know", she replies. The problem is drawing comparisons and defining what is good. "We are sad because each year there are less students. They leave with their families and ... all their conversations relate to leaving", states one teacher. It is also sad when the teachers leave. "As soon as I finish 9<sup>th</sup> grade, -says someone- I'll join my brother". And he is happy. What about the parents? "We will take them too. Everyone", says one of the girls ... "I have been abroad. It is pretty. Clean. Germany is a big country...It is peaceful. I am not afraid. There are fine things and many rules". Lack of justice is deeply ingrained in these children. They are right. So, could it be peacefulness that makes them leave?! Here, they study and attend a fairly good school, it is really peaceful, somewhat, indeed the kind of foreboding that ... quite soon it will be over. I am afraid that even the open-minded teachers accompanying us wait for the opportunity. How would you feel if there were no students left? - I ask the gym teacher. "Well, the children are dwindling. There is always fewer of them and pretty soon we will be alone", shakes his head. But aren't there any policies? Who needs to keep this dimming fire alive? Someone should think! And the mind wandered remembering an accusation that has become common among our country's officials nowadays, and even conspirators popping up everywhere: Germany is forcibly taking our people, and it cynically appears that there is an indirect bitter truth, while we only keep cursing our country, whereas poverty and destitution have frustrated us up to the point where we do not know what ... we want.

## Zogaj

Koha është ftohur disi, por era e këndshme që vjen prej Liqenit të Shkodrës dhe mbi të gjitha paqësia që rrjedh ngado e lehtëson ditën. Zogaj shtrihet në perëndim të qytetit dhe ka një përzierje klimash që e bën ndërrimi i masave ajrore që shndërrohen nga Liqeni i Shkodrës, nga jugu me Malin e Taraboshit me Lumin e Bunës dhe nga perëndimi me kufirin shtetëror me Malin e Zi. Ka pak sipërfaqe të karakterit fushor dhe një vijë liqenore që ia vlen për turizëm. Sot, në Zogaj ka 107 familje me mesatarisht 3.6 pjesëtarë, por që çuditërisht kanë avantazh statistikor sa i përket pjesëmarrjes femërore. Është fshat i peshkatarëve dhe me këtë kulturë mbajnë jetën. Bedri Guri, 55 vjeç, gjuan vetë dhe nuk është në një si shoqëri të përbashkët, që kanë ngritur peshkatarët. Ankohet pak, por jo se nuk është me të tjerët, por për forcë zakoni. Trupi i fortë i kalitur i bën ballë kësaj pune dhe sfidave të tjera. Ka tre fëmijë në mos gabojmë dhe mendon se në të ardhmen, të gjithë do të largohen. *“Askush nuk kujdeset për liqenin”, e bën me sy nga suprina e madhe e liqenit të madh. Nuk e ka problem foton, por më shumë pyetjet tona. “Po çfarë mund të bësh këtu? Punojmë dhe përditë bëhet më keq. Nuk ka rregull, nuk ka ligj. Si mund t’ua mbushësh mendjen fëmijëve të rrinë këtu. E kanë në dorë celularin e dëgjojnë çbëhet në botë. I kam të mbarë dhe ata janë jeta ime, por bash dhe unë...nuk e di”.* Në breg, poshtë shkallëve të një qendre asosacioni peshkatarësh, tashmë në formë simbolike dhe godinës pa njerëz të saj, duke u marrë me rrjetat janë Hilmi Neziri, 75 vjeç, Remzi Patushi, 24 vjeç dhe i biri në mos gaboj Ilir Neziri, 42 vjeç. Janë shumë refuzues dhe madje shumë të idhnuar. Fjalori që shkëmbejnë duhet të jetë aty tek 300 fjalët. Do kenë pasur eksperiencë të këqija! Në fakt, shpesh raportohet sesi gjuhet me

## Zogaj

The weather has chilled, but the pleasant wind blowing from the Shkodra Lake, and above all, the peacefulness floating around lightens the day. Zogaj extends to the west of the city and has a mix of climates due to the clash of air masses that are transformed by the Shkodra Lake, Mount of Tarabosh and Buna River to the south and the state border of Montenegro to the west. It features a modest plain surface and a shoreline that would attract tourism. Nowadays, Zogaj has 107 families with an average of 3.6 members, where females strangely have a statistical advantage. It is a fishermen's village upon which they subsist. Bedri Guri, 55 years-old, fishes by himself and is not a member of the joint association established by other fishermen. He complains, not because he has not joined the rest, rather as a force of habit. His strong hardened body can take on this job and other challenges. He has three children, I believe, and thinks that in the future, they will all leave. *“No one cares for the lake”* and casts his gaze on the large surface of the great lake. He does not mind being photographed, but our questions. *“Well, what can you do here? We work and it gets worse every day. There are no rules, no laws. How can you convince children to stay here? They have their smartphones and see what happens all over the world. They are good children, and they are my life but even I ... I don't know”.* At the shore, below the stairs of a fishermen association center, and now symbolically, its empty building, Hilmi Neziri, 75 years-old, Remzi Patushi, 24 years-old and the son, if I'm not wrong, Ilir Neziri, 42 years-old are mending their nets. They are quite dismissive and even pretty angry. Their vocabulary extends to about 300 words. They must have had bad experiences! In fact, it is often reported how blast fishing is being practiced, how generators are



dinamit, si përdoret gjeneratori për peshkun dhe kundravajtje të tjera dhe policia...vjen pas kohe. Shteti nuk u gjendet dot edhe asnjëherë. “Media është ajo që prish më shumë. Përsërisim të njëjtat gjëra. Nuk bëhet asgjë. Ndaj,- Hilmiu më tregon të birin, Ilirin andej,- të gjithë duan të ikin. Nuk e di pse po rrinë dhe këta”. Burri nuk e ngre kokën nga rrjetat. E shpreh hapur që e bezdisim dhe madje në një formë jo shumë të sjellshme. “A e di, më thotë një nga peshkatarët e tjerë pak më tutje- kapim gjithnjë e më pak peshk dhe jo se nuk ka. Por nuk na mbron policia nga të fortët. Tregtarët, pastaj, nuk na e marrin prodhimin. Nuk... dhe nuk...Kur të vini herën tjetër, mbase nuk do shini më edhe peshkatarë, sepse brezi i ri nuk e do më këtë punë”. Më të rinjtë nuk flasin, duket sikur i mbajnë peng aty.

used for fishing and other violations and the police ... arrives too late. The government is never here for us. “The media is the one causing more trouble. We repeat the same things. Nothing gets done. So,- Hilmi points at his son, Ilir,- everyone wants to leave. I do not understand why they stay”. The man does not take his eyes off the nets. He openly expresses his annoyance with us, even in a slightly rude manner. “Do you know, one of the fishermen standing a bit further away addresses me – we are always catching fewer fish and not because there aren't any. The police do not protect us from the “big guys”. And the merchants do not buy our products. Not...and not... When you come here next time, perhaps you will not see any more fishermen, because the young generation does not like this job”. The younger ones do not speak, as if they are being held hostage.



## Intermexo

Kryeministri Edi Rama, gjatë një fjalimi para socialistëve të mbledhur në sallën e teatrit Ar-Turbina, ka shpjeguar arsyen pse shqiptarët po largohen nga Shqipëria. Nuk ka shpopullim, e thotë i bindur, dhe kush e thotë këtë, “ose nuk kupton asgjë, ose është i poshtër”, iu drejtua vartësve krejtësisht heshtakë. “Jemi në një botë ku lëvizja ka një tjetër hapësirë dhe tjetër shpejtësi. Jemi në mes të një kontinenti ku shumë afër nesh është epiqendra e pasurisë së botës. Patjetër që një të riu që ndodhet në një fshat kudoqoftë në Shqipëri, i cili me një klikim ka pranë Kim Kardashianin dhe Cristiano Ronaldo, nuk është e lehtë t’i thuash “rri këtu se do të bëjmë bashkë Shqipërinë”. Patjetër që ikja e njerëzve ka brenda edhe problemet e veta, por kush thotë se ikja e njerëzve lidhet me qeverisjen, ose nuk kupton asgjë, ose është i poshtër”.

## Intermezzo

The Prime Minister Edi Rama, during a speech to the socialists gathered at the hall of ArTurbina theater, explained the reason why Albanians were leaving the country. There is no depopulation, he asserts, and whoever states this, “either doesn’t understand a thing, or is simply mean”, addressed his quite silent subordinates. “We live in a world where mobility is characterised by another space and velocity. We find ourselves in the middle of a continent, near the epicenter of the world’s wealth. Of course, to a young person in any Albanian village, where Kim Kardashian and Cristiano Ronaldo are only one click away, it is not easy to dictate “stay here and we’ll build Albania together”. Certainly, people leaving is problematic, but whoever states that this is linked to the government, either does not understand a thing or is simply mean”.

## Torovica

E vetmja shtysë në këtë ditë kaq të turbullt është se po i afrohem fundit. Nga radioja e makinës po dëgjoj një lajm: Ronaldo ka thyer sërish një rekord me golin e një dite më parë. Më vjen në kokë fjala e Ramës, po ç'i hyn në punë vallë një shqiptari Ronaldo, veç për bastet?! Ndërrojmë biseda dhe çuditërisht kur bashkohet i gjithë grupi atëherë kuptojmë se bëjmë të njëjtën bisedë. Pse jemi kaq të hapur nga braktisja? Çfarë ngjyre ka nostalgjia? Ku është vendi yt? Po një pjesë janë të rinj dhe bisedat i kanë shumë më pragmatike. Torovica na rikthen në zymtësi. Grihnaja e Zogajt, që zbutet nga ngjyrat dimërore të Liqenit, tashmë të kthehet në një kaki të frikshme. Ky vend mund të jetë shumë mirë një skenografi jetësore e ndonjë filmi. A mund ta duash vallë një atdhe të tillë, me këto ngjyra? *“Kur ne fillojmë e flasim për shtëpinë dhe atdheun ne përjetojmë rënien e parë të mirëardhjes në shtëpi”*, kujton Svetlanën Boym te “Nostalgia”. Para viteve ‘90 Torovica e Lezhës ishte një nga qytezat më të zhvilluara, jo thjesht përse i përket prodhimeve bujqësore, por shërbente edhe si një furnizues për shumë zona të tjera të Veriut. Dhe, për të prishur syrin e keq, në brendësi të saj, mbante edhe ish-kampin e internimit, i cili u popullua vrulltas, por këtë herë me vuajtës të tjerë, ata që kërkonin El Doradon e Socializmit. Dhe, çfarë? Të 5.500 banorët kanë furrar në gjysmën sepse gjysma e tyre kanë emigruar në kërkim të një jete më të mirë. Një rrugë e shkatërruar është skena ku banorët numërojnë me zili njëri-tjetrin mëngjeseve karvanin e atyre që ngarkojnë plaçkat drejt një destinacioni të ri. Nga ky vend, që mendonin se do të ishte stacioni, shumë kush është larguar pas disa dekadash jetesë në të. *“Kemi ardhur po do ikim”*. Kaq kuptoj nga një tufë djemsh që përzien dhe mundohen të na sajdisin në një klub shkatarraq, ku platfor-

## Torovica

The only motivation on this gloomy day is that we are approaching the end. I am listening to the news from the car radio: Ronaldo has set another record with his goal yesterday. I remember Rama's words, but what good is Ronaldo to an Albanian, besides betting?! We exchange talks and when the whole group gets together, we realise that we are all engaging in the same conversation. Why are we so open to abandonment? What colour is nostalgia? Where is your country? However, some of them are young and their conversations are more pragmatic. Torovica takes us back to gloominess. Zogaj's grayness, which was softened by the winter colours of the Lake, now transforms into a scary khaki. This place could very well be a living scenography for a movie. Could you possibly love such a homeland, with these colours? *“When we start talking about the home and the homeland, we experience the first fall of home welcoming”*, reminds Svetlana Boym in “Nostalgia”. Before the 1990s, Torovica of Lezha was one of the most developed small towns, not only regarding agricultural production, but it also supplied many areas of the North. And to ward off the evil eye, hidden within, it housed the former internment camp. The latter was hastily populated, but this time with other sufferers, those looking for the El Dorado of Socialism. And, what? The 5,500 inhabitants have dwindled to half, as the rest has emigrated in search for a better life. A ruined road represents the stage where in the morning inhabitants enviously count the trail of those carrying their belongings towards a new destination. Many people, who once considered it the final station and lived here for decades, have moved away. *“We have come here, but we'll leave”*. This much I understand from a group of young men who mingle and try to accommodate us in a run-down bar. Here, the platform and cheap tiles and wind blow-



mat dhe pllakat e lira dhe një erë që të fryn nga dritaret e penxheret ta bën ditën më të keqe. Por janë shumë mikpritës dhe nuk kanë turp të thonë se janë depërtuar dhe se do ikin sërish, por që punën s'ua ka qejf shumë ënda. Janë krenarë dhe dikush flet keq gjermanisht. Janë tipikë bjerraditës të kënaqur, që kanë vetëm një qëllim në jetë: Ikjen. *"A mund të jetosh këtu?"* Po ju vetë duhet ta ndryshoni?-i thotë miku gjerman i teatrit. *"Nuk na dalin paratë. Pushteti lokal është i korruptuar"*. Ai do t'i bëjë pyetje më të thelluara, por ata me fytyrat e shëndetshme dhe të kënaqur ia presin shkurt por sjellshëm dhe e ftojnë ngultas për birra. *Po pse i zgjidhni këta zyrtarë?-ia pret një praktikant i ri gjerman i KAS. "Po, kështu jemi ne. Edhe unë po të zgjidhem do të korruptohem. Këtë vend e ka braktisur Zoti, si do mund ta bëjmë ne..."*.

U tregoj diçka miqve për viktimat e guroreve lokale, për gurët që bien shpesh nga mali drejt fushës e që rrezikojnë jetë njerëzish. Këtu mizanskenat e dështimit të socializmit janë të gjalla me imazhin e ndërtimeve dhe mungesën totale të kujdesit. Shumë shtëpi janë nxjerrë në shitje, ndonëse pak shpresa ka për blerës. *"Shtëpinë e vendosa në shitje vetëm për një motiv, ky vend ka vdekur me gjithkënd e nuk ngjall shpresë"*, thotë një nga banorët, që bezdiset nga pyetjet. Ndue Përllëshi 71 vjeç që bujtim për pak mundohet të na sajdisë dhe befasi merr edhe të birin në telefon në Gjermani, që të sigurohet *live* se çfarë duan të huajt në shtëpi të tij. Ai është nga *"të kamurit"* e vendit, pasi të bijtë që janë jashtë blenë tre apartamente në të njëjtin pallat. Djali kënaqet duke folur gjermanisht me kolegun e teatrit, kurse me një gjermanishte emigranti i tregon punën dhe mbijetesën. Nuk e di sesa korrekte është gjuha e tij. Pleqtë ndihen krenarë...*"E shikon sa mirë që flet. Ai na bleu shtëpitë. Çfarë do bënte këtu? Ishte pa dokumente. U rregullua, mori dhe të vëllanë"*. Po jeni vetëm! Ai vazhdon njësoj: *"Po djali aman e flet mirë gjuhën.*

ing through the windows make the day worse. But they are very welcoming and not ashamed to share that they have been deported and will go back again, even though they dislike the work. They are proud and someone speaks broken German. They are typical happy loafers, with only one purpose in life: Leaving. *"Can you live here?"* Should you change it? -asks the German theater guy. *"Money is not enough. The local government is corrupt"*. He wants to enquire further, but they, with their healthy and content faces kindly cut him short and insist on beers. *Why do you elect these officials?* – asks the new German KAS intern. *"Well, this is who we are. If I were elected, I would also be corrupt. This is a Godforsaken place; how can we build it..."*.

I explain something to my friends about the victims of the local quarries, about the rocks that often fall from the mountain on to the fields and endanger people's lives. Here, the staging of social failure is alive with the image of the buildings and total lack of care. May houses are for sale, albeit there is little hope for buyers. *"I put my house on sale only for a reason, this place is dead and hopeless"*, says one of the inhabitants, irritated by the questions. Ndue Përllëshi, 71-years-old, where we are staying for a while tries to accommodate us and suddenly calls his son in Germany, so that he can be assured *live* of what the foreigners are doing in his house. He is one of the "rich" persons in town, as his sons who live abroad bought three apartments in the same building. The son enjoys speaking German with the theater guy, while speaking with an emigrant's dialect in German he talks about work and survival. I do not know how fluent he is. The old man is proud ... *"Do you see how well he speaks. He bought our house. What would he do here? He did not have any papers. Then, he got them in order, and accommodate his brother"*. But you are alone! He goes on in the same manner: *"Well, my son speaks the language fluently. They help us. They have bought houses for each*

*Na ndihmojnë. Kanë blerë shtëpi për njëri-tjetrin dhe kënaqen. Eh moj Gjermani...uroj të gjithë të ikin në Gjermani. Të bëhen njerëz dhe të mos rrinë një dedik këtu, në këtë vend...".*

*"Këtu nuk kalon as tanksi", "Këtu nuk ka as ujë të pijshëm e dritat janë si shkollë nate". Kujtoj nga këto fjali djemtë hokatarë, që presin të ikin dhe që më thonë se rrinë këtu sa të rregullojnë dokumentet. Po ti je i depërtuar, i them dikujt. "Eh çfarë, pse nuk bëj dot pasaportë tjetër" Më kujtohet plaka, që shkëputet për të bërë një set fotosh. "Gjoja erdhëm për një vend më të nxehtë për dimrin. Më mirë është këtu, këtu të paktën spitalin e kemi në derë të shtëpisë, kurse atë nga vij unë për një spital vdes", tregon e moshuara 72-vjeçare, ndërsa entuziazmi i bie shpejt, sapo i përmend gjendjen ekonomike të familjeve në Torovicë. "Na për zotin jetojmë me të keq. Jemi fukarenj. Këtu çka punon djali që e bën me copa punën jashtë shtetit, ku i del ndonjë punë. Ujë nuk ka, vetëm me të blerë, do lekë të madh. Tokë kishim blerë një 3 dynym, por na ndih djali, që Zoti ia shtoftë jetën", na thotë Tereza me veshjen karakteristike, por që i pëlqen ky vend. Është e vetmja që më thotë se e pëlqen, por tek e fundit çfarë do mundë të kërkoj në këtë mynxyrë më shumë nga jeta. Ikim. Ngadalë që të mos i bezdisim në mirësinë e tyre dhe në këtë harresë, që duket sikur ua vjedhim me pyetjet tona.*

...

*Ndoshta një nga mjetet për ta harruar këtë lloj gjendje është arti, por edhe ai i propozuar është i dhimbshëm. Mes disa autorëve, Nabukov u përpoq të përdorë artin e shkërbimit, duke folur për përvojat personale dhe kënaqësitë duke luajtur mes kujtimeve dhe shpresës, duke u munduar ta mbajë të gjallë nostalgjinë, si pjesë normale të së dikurshmes. Por, këta, edhe këtë duan ta humbin. Duan të fshijnë kujtimin e vendit të tyre. Ky është qëllimi dhe synimi. Nga 10-vjeçari deri te i moçmi. Medet, Shqipëria ime! Për shqiptarët është gjithmonë dje. Edhe për ne grupin, që kthehem në pagojë...në Tiranë.*

*other and are satisfied. Eh, Germany ... I wish everyone could move to Germany. Be someone and not stay even one moment here, in this place...".*

*"Not even a tank passes here"; "There is no drinking water, and the electricity is so weak". These sentences remind me of the hilarious young men who told me how they were going to leave as soon as their papers were in order. But you have been deported, I said to one of them. "Eh, what, I can get another passport". I remember the old woman, who steps away to have the photo shoot: "Supposedly we came for a warmer place for the winter. It is better here, at least here the hospital is on our doorstep, whereas where I come from you die before reaching the hospital", explains the 72-year-old, whereas her enthusiasm quickly dissipates when mentioning the economic condition of families in Torovica. "By God, we live terribly. We are poor. Our son helps us whenever he goes abroad and finds a job. There is no water, you must buy it, that costs a lot of money. We bought some land, about 3 dunam, our son helped us, God bless him", says Tereza with her characteristic clothing, who likes this place, nonetheless. She is the only one who admits to liking it, but after all what more could she ask for from life amid such misfortune. We leave. Slowly, so that we do not upset them in their kindness and in such oblivion, which we seem to take away with our questions.*

...

*Perhaps one of the means to forget this kind of state is art, but even the proposed one is painful. Among several authors, Nabokov attempted to use the art of imitation, by talking about personal experiences and the joys of playing between memories and hope, trying to keep nostalgia alive, as a normal part of the bygone. But they even want to erase this. They want to eradicate the memory of their country. This is the purpose and objective. From the ten-year-old to the eldest. Alas, my Albania! To Albanians it is forever yesterday. Even to our group, who returns speechless...to Tirana.*



